

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
 Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
 Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7867 E hënë 29 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Rezoluta ose mocioni (tërheja Re vëmendjes) i Parlamentit të Holandës i datës 16 prill 2019, për t'i propozuar Këshillit të Evropës rikthimin e regjimit ...
 Vijnë në faqen 20

Nga **FATOS ÇOÇOLI**
Donkishotët e integritimit


Opinion *i* **Ditës**
Autoritarizmi psikopatik është ulur këmbëkryq në Shqipëri. Është autoritarizëm, sepse shpërdoron e dhuron çdo ligj, si dhe të drejtën për të vënë firmën në çdo ...
 Vijnë në faqen 21

Nga **PETRIT VASILI**
Autoritarizmi psikopatik, krimi dhe Edi Rama në mes!




Aleatët, dakord për një platformë bashkëpunimi

PS hyn në zgjedhje me koalicion, marrëveshja me 22 parti firmoset nesër

Zgjedhjet pa opozitën, gjysma e votuesve mbeten pa përfaqësim. Në parlamentaret e 2017-ës, rezultati i barabartë

Mazhoranca e majtë është treguar e vendosur ditët e fundit që të shkojë në zgjedhje edhe pa opozitën. Madje, kryeministri Edi Rama në të gjitha fjalimet e fundit publike ka përjashtuar gjithashtu çdo mundësi tjetër për të arritur një marrëveshje si ajo e 18 majit 2017, që do t'i krijonte mundësi opozitës të rifutej në zgjedhje nëpërmjet një kompromisi politik ...

Në faqet 2-3

TABELAT E PLOTA ME NDRYSHIMET E DALJES NE PENSION PER BURRAT DHE GRATE

PENSIONET, JA SA RRRITET MOSHA 5 VITET E ARDHSHME

ISSH: Cilat janë kushtet e përfitimit të pensionit të pleqërisë, dokumentacioni që ju nevojitet për të marrë kontributin tuaj



(Në foto) Tabelat me moshën e daljes në pension pleqërie

Për burrat	Moshë				
	1960	1965	1970	1975	1980
1.1.2019	65	65	65	65	65
1.1.2020	65	65	65	65	65
1.1.2021	65	65	65	65	65
1.1.2022	65	65	65	65	65
1.1.2023	65	65	65	65	65
1.1.2024	65	65	65	65	65
1.1.2025	65	65	65	65	65
1.1.2026	65	65	65	65	65
1.1.2027	65	65	65	65	65
1.1.2028	65	65	65	65	65
1.1.2029	65	65	65	65	65
1.1.2030	65	65	65	65	65
1.1.2031	65	65	65	65	65
1.1.2032	65	65	65	65	65
1.1.2033	65	65	65	65	65
1.1.2034	65	65	65	65	65
1.1.2035	65	65	65	65	65
1.1.2036	65	65	65	65	65
1.1.2037	65	65	65	65	65
1.1.2038	65	65	65	65	65
1.1.2039	65	65	65	65	65
1.1.2040	65	65	65	65	65
1.1.2041	65	65	65	65	65
1.1.2042	65	65	65	65	65
1.1.2043	65	65	65	65	65
1.1.2044	65	65	65	65	65
1.1.2045	65	65	65	65	65
1.1.2046	65	65	65	65	65
1.1.2047	65	65	65	65	65
1.1.2048	65	65	65	65	65
1.1.2049	65	65	65	65	65
1.1.2050	65	65	65	65	65

(Në foto) Tabelat me moshën e daljes në pension pleqërie

Në faqen 7

INTERVISTA
Basha: Shqipëria në udhëkryq, të dënojmë politikanët e lidhur me krimin
 Në faqen 4

FTESA
Samiti i Berlinit, Merkel takon Ramën, Shqipëria e Maqedonia presin negociatat
 Në faqen 5

ATMOSFERA
Pashkët zbukurojnë qytetin, turistët festojnë me birrën "Korça"
 Në faqen 12

INTERVISTA
Dr. Klodian Muço: Milionat që janë vjedhur e si shpëtohet ekonomia
 Në faqen 6

EMRAT
Përplasje me armë në Laç, vdesin dy kushërinjtë
 Në faqen 9

Mjeku gastroenterolog: Cilat janë simptomat e shkaqet kryesore të sëmundjes

Altin Çekodhima: Dieta për të shpëtuar nga hemorroidet

Ylli Merja: Rënia e flokëve, si ta kuroni me bimë mjekësore

NGA VOLTIZA DURO
Hemorroidet prekin një pjesë të konsiderueshme të popullsisë e veçanërisht pas moshës 50 vjeç. Ato janë një prej sëmundjeve të anusit dhe rektumit e shkaktojnë kruajtje e djegie përreth zonës së prekur. Në një interv-



istë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku gastroenterolog dhe endoskopist, Altin Çekodhima tregon simptomat kryesore të sëmundjes si dhe mënyrat e diagnostikimit. Ai shton se hemorroidet mund të jenë të ...

Suplement

VENDORET KOALICIONI

Në zgjedhjet e 2015-ës, partitë e opozitës kanë marrë më shumë se 60% të votave

Zgjedhjet pa opozitën, gjysma e votuesve mbeten pa përfaqësim

Në parlamentaret e 2017-ës, rezultati i barabartë

Mazhoranca e majtë është treguar e vendosur ditët e fundit që të shkojë në zgjedhje edhe pa opozitën. Madje, kryeministri Edi Rama në të gjitha fjalimet e fundit publike ka përjashtuar gjithashtu çdo mundësi tjetër për të arritur një marrëveshje si ajo e 18 majit 2017, që do t'i krijonte mundësi opozitës të rifutej në zgjedhje nëpërmjet një kompromisi politik. Por, sado ligjore të mund të jenë një palë zgjedhje të tilla, ato natyrisht nuk do të ishin morale. Jo vetëm se do të mungonte alternative e opozitës kryesore, por edhe sepse më shumë se gjysma e votuesve shqiptarë do të ishin të papërfaqësuar në këto zgjedhje. Po të shikojmë rezultatet e dy zgjedhjeve të fundit që janë mbajtur në vend, ato të 2015-ës dhe 2017-ës, partitë opozitare që kanë vendosur të mos futen në zgjedhje kanë marrë më shumë se gjysmën e votave të të gjithë shqiptarëve, madje në rastin e zgjedhjeve lokale të 2015-ës, kjo diferencë thellohet edhe më tej.

LOKALET 2015

Në zgjedhjet lokale, konfigurimi i koalicioneve do të ishte krejt i ndryshëm nga sa është sot. Në ato zgjedhje PS-ja krijoi një koalicion të madh, duke përfshirë edhe forca që sot kanë kaluar në opozitë. Për më tepër këtu Lëvizjen Socialiste për Integrim, e cila në 2015-ën do të merrte plot 260 mijë vota, duke thyer një rekord të vetin që nga koha e krijimit të saj. Një tjetër forcë që ishte pjesë e koalicionit të PS-së dhe që sot ka kaluar në opozitë me socialistët është PDIU e Shpëtim Idrizit. Edhe kjo forcë në ato zgjedhje siguroi plotë 60 mijë vota. Një tjetër forcë që në ato zgjedhje ishte me PS-në dhe tashmë ka kaluar në opozitë me të është PDK e Nard Ndokës, e cila arriti të marrë 20 mijë vota. Pra, në total vetëm këto 3 forca i dhanë koalicionit të PS-së në 2015-ën 340 mijë vota



REZULTATET

Zgjedhjet lokale 2015

PD - 317.620 vota
LSI - 259.934 vota
PDIU - 59.701 vota
PR - 53.784 vota
PDK - 20.271 vota
PBKD - 14.116 vota
PAA - 13.400 vota
PLL - 13.812 vota
LZHK - 19.644 vota
PBDNJ - 14.771 vota
Në total opozita 787 mijë vota

Koalicioni i PS pa LSI, PDIU dhe PDK - 653 mijë vota

Zgjedhjet e vitit 2017

PD - 456.481
LSI - 225.975 vota
PDIU - 76.064 vota
PR - 3.211 vota
Koalicioni opozitar 761 mijë vota

PS - 764.791 vota

forcat që sot janë rreshtuar në opozitë, atëherë rezultojnë se ato në 2015-ën kanë marrë të gjitha së bashku 787 mijë vota. Pra, afro 180 mijë vota më shumë se sa do të kishte koalicioni i PS-së. Ndaj, në rast se opozita nuk do të bëhet pjesë e zgjedhjeve vendore, në bazë të rezultateve të 2015-ën, më shumë se 60 për qind e votuesve që i përkasin opozitës nuk do të kishin më një alternativë për të cilën të votonin.

PARLAMENTARET 2017

Situata duket se balancohet në zgjedhjet parlamentare të 2017-ës, ku opozita aktuale dhe koalicioni që përfaqëson PS-në janë thuhet barabartë me vota. Kështu, të gjitha partitë e koalicionit opozitar në 2017-ën kanë marrë 761 mijë vota, ndërkohë që PS-ja dhe aleatët e saj, 765 mijë vota. Pra, edhe në rastin më të mirë, pra atë të 2017-ës, sërish mospjesëmarrja e opozitës në zgjedhje do t'i hiqte mundësinë për të pasur një alternativë për të votuar rreth gjysmës së votuesve shqiptarë. Ndaj, në këtë aspekt mospjesëmarrja e opozitës në zgjedhje do t'i bënte zgjedhjet moralisht iligitime, pasi do të linte pa përfaqësim në rastin më të mirë gjysmën e votuesve dhe në rastin më të keq, rreth 60 për qind të tyre.



Bumçi: Përshkallëzim i protestës, zgjedhjet pa opozitën fundi i Ramës

Opozita është e vendosur të vazhdojë të përshkallëzojë reagimin qytetar deri në rrëzimin e Edi Ramës si kryeministër. I ftuar në studion e emisionit "Politika Online" në "Gazeta Shqiptare" dhe "Balkan Web", ish-deputeti demokrat, Aldo Bumçi foli me tone të ashpra ndaj sjelljes së qeverisë, e cila sipas tij, çdo ditë e më shumë po varfëron dhe dhuron shqiptarët. "Do vazhdojë me protesta, bllokime rrugësh, institucionesh. Pra, përshkallëzim i protestës deri në rrëzimin e Edi Ramës. Nuk ka kthim prapa. Ne jemi në rrugë dhe i gjithë fronti opozitar është i bashkuar", - tha Bumçi. Sipas tij, sot shqiptarët kanë vrarë frikën dhe kanë dalë në rrugë kundër qeverisë. "Nuk ka njeri më të pashpirt dhe të dhunshëm se Edi Rama. Ku ke parë tjetër veçse këtu që t'i nxjerrësh njerëzit nga shpëtitë e tyre me gaz lotsjellës?! Ky shkon dhe dhuron gra dhe fëmijë. Sot jemi një republikë e kapur nga një person. Kjo është republikë e një personi. Nuk ka Gjykatë Kushtetuese, nuk ka Gjykatë të Lartë, Edi Rama kontrollon çdo gjë", - tha Bumçi. Ai u shpreh se tashmë qeveria është grahamat e fundit dhe tashmë shenjat janë të qarta. Nga ana tjetër, ai theksoi se zgjedhje nuk do të ketë. "Nëse zgjedhjet do mbahen pa opozitën, atëherë kjo do jetë fundi i tij. Nuk do ketë zgjedhje pa opozitën dhe ne do të përdorim çdo mjet", - u shpreh Bumçi, duke theksuar se kërcënimet e qeverisë nuk e trembin opozitën.



SHKURT

Kume: Regjistrimi i "Bindjes Demokratike", në kundërshtim me ligjin

Ish-kryetari i KQZ-së dhe një nga ekspertët e çështjeve zgjedhore, Kristaq Kume, vlerëson si të paligjshëm regjistrimin e partisë "Bindja Demokratike" si subjekt zgjedhor për votimet e 30 qershorit. Npërmjet një komentari në rrjetet sociale, Kume thotë se regjistrimi i partisë së Astrit Patozit është bërë në mos pajtim të hapur me ligjin. Sipas tij, ky vendim nxjerr edhe një herë në pah nevojën për të pasur një administratë zgjedhore jopolitike dhe që i shërben ligjit dhe jo interesave të partisë që e propozon. "Regjistrimi i partisë 'Bindja Demokratike' si subjekt zgjedhor nga KQZ, në mos pajtim të hapur me ligjin është një fakt akoma më shumë në mbështetje të domosdoshmërisë për ndërtimin e administratës zgjedhore, përfshirë edhe KQZ-në, jo më përfaqësues të partive politike. Komisionerë të tillë janë 'të kapur' nga partia që i propozon deri në masën sa arrijnë edhe deri në mohimin profesional të vetes", - shkruan Kume. Sipas tij, depolitizimin e administratës zgjedhore e kanë kërkuar edhe të gjithë raportet e fundit të OSBE-ODIHR-it. "Në raportet dhe rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe atyre vendore, por jo vetëm, nevoja për të ndërtuar një administratë zgjedhore sa më pak të ndikueshme nga partitë politike theksohet në mënyrë të veçantë. Tri raportet e fundit e theksojnë këtë nevojë, duke e renditur rekomandimin përkatës ndër rekomandimet prioritare. Angazhimi për zbatimin e tij është i domosdoshëm, nëse duam që të hedhim një hap më përpara drejt objektivës për të zhvilluar zgjedhje demokratike", - shprehet Kume. "Bindja Demokratike" u regjistrua të shtunën nga KQZ-ja si pjesë marrëse në zgjedhjet e 30 qershorit, por kryetari i KQZ-së dhe PD-ja e kundërshtuan këtë vendim, duke pretenduar se vendimi i gjykatës nuk ka marrë formë të prerë.





Aleatët kanë rënë dakord për një platformë dhe marrëveshje bashkëpunimi

PS-ja në zgjedhje me koalicion, marrëveshja me 22 parti firmoset nesër

Të dyja dokumentet janë hartuar nga Koçi dhe Koja

Në 1 maj përfundon afati ligjor i regjistrimit të koalicioneve elektorale për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Ndryshe nga zgjedhjet e shkuara parlamentare, kësaj here socialistët, pavarësisht se përballë nuk kanë një kundërshtar real, pra opozitën e vërtetë, kanë vendosur që të shkojnë në votime me një koalicion të tyrin, që përbëhet nga më shumë se 22 parti politike. Burime nga Partia Socialiste kanë bërë me dije se kanë mundur të konkludojnë me sukses konsultimet dhe negociatat me të gjitha partitë aleate, me të cilat kanë rënë dakord që të krijojnë një koalicion zgjedhor. Në emër të Partisë Socialiste ka negociuar Petro Koçi, ndërsa në emër të partive aleate ka negociuar ish-ministri i Shëndetësisë, aktualisht kreu i Partisë Socialiste të Moderuar, Gjergji Koja. Koalicioni për të cilin kanë rënë dakord do të funksionojë mbi bazën e një marrëveshjeje dhe platforme të dakordësuar më parë mes PS-së dhe aleatëve dhe që sipas të njëjtave burime do të nënshkruhet gjatë ditës së martë, për t'u dorëzuar më pas në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kështu, fillimisht Koçi dhe Koja kanë hartuar një draftmarrëveshje dhe një draftplatformë bashkëpunimi, që iu është shpërndarë të gjitha partive që kanë shprehur parimisht vullnetin për të qenë në një koalicion zgjedhor me Partinë Socialiste. Kjo, për t'i njohur aleatët me përmbytjen e këtyre dokumenteve dhe për t'u dhënë mundësi atyre që të bëjnë sugjerimet dhe vërejtjet konkrete. Proces ky që është realizuar gjatë javëve të fundit, ndërsa të premtën e shkuar është zhvilluar një takim me pjesëmarrjen e afro 22 partive, të cilat kanë dakordësuar edhe përmbytjen e këtyre dokumenteve. Më pas, ato i kanë kaluar për vlerësim sekretarit të përgjithshëm të PS-së, Taulant Balla dhe kryeministrit Edi Rama. Të njëjtat burime kanë bërë të ditur se këto dokumente kanë



BASHKËPUNIMI
Mësohet se PS-ja në bazë të peshës specifike që ka secila forcë në elektorat, dhe kjo bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme, do të bëjë edhe përfshirjen e emrave të veçantë në vendet e sigurta në listën e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë. Burime të tjera nga kampi i majtë bëjnë të ditur se pjesë e këtij koalicioni janë kryesisht forca që edhe në zgjedhjet vendore të 2015-ës dolën në një koalicion me Partinë Socialiste, me përjashtime të vogla.

lave bashkiakë. Burime të tjera nga kampi i majtë bëjnë të ditur se pjesë e këtij koalicioni janë kryesisht forca që edhe në zgjedhjet vendore të 2015-ës dolën në një koalicion me Partinë Socialiste, me përjashtime të vogla. Kujtojmë këtu që ndër partitë që ishin pjesë e koalicionit elektorat të 2015-ës me PS-në dhe që sot janë në opozitë janë LSI, PDIU dhe PDK. Ndërkohë që këtij koalicioni i është shtuar vetëm Partia Socialdemokrate e Skënder Gjinushit. Po ashtu, jashtë këtij koalicioni mësohet se janë edhe FRD e Bamir Topi, Aleanca e Kuq e Zi, Zgjidhja, Partia Ligj dhe Drejtësi apo edhe Aleanca Demokratike e Zef Bushatit. Partia Socialiste është angazhuar plotësisht që jo vetëm të fitojë në zgjedhjet e 30 qershorit përballë disa partive anonime, por edhe të marrë të gjitha bashkitë, përfshi këtu edhe ato forca që deri më tani janë drejtuar nga demokratët, si Shkodra dhe Kukësi. Gjithsesi, për t'i futur këto bashki socialistëve nuk do u duhet domosdoshmërisht koalicioni, pasi mund të fitonin edhe vetëm, por kjo do të ishte një ndihmesë e madhe në rast se opozita nëpërmjet një marrëveshjeje do rikthehej në garë.

SHKURT

U përjashtua nga PS-ja, Gjetani: Administrata po gëlon nga militantët

Deputeti socialist i Kurbin, Gjetan Gjetani, i përjashtuar nga grupi i PS-së disa muaj më parë pas kritikave ndaj situatës së rendit dhe Ministrisë së Brendshme, është shprehur sërish kritik ndaj mënyrës se si po qeveriset vendi dhe në mënyrë të veçantë zona e tij zgjedhore. Nëpërmjet një komentit të gjatë në rrjetet sociale. Ai ka akuzuar direkt kryeministrin dhe ministrat e tij për gjendjen dhe mënyrën sesi funksionojnë sot institucionet në Kurbin. "Pak ditë më parë kryeministri Edi Rama, gjatë një takimi me studentët krekosej se falë tij ishin mbyllur 'kioskat' private, e teksa ai fliste, ndërmend më vinin drejtorët e rinj të institucioneve në Kurbin, të cilët pasi kryen 'shkëlqyeshëm' gjimnazin në vitet e arta 1997-2005, pas eksperiencave të fituara në Milano më në fund u diplomuan në disa kioska private pak vite më parë e sot mbajnë poste drejtorësh. Ata kanë sjellë ndryshime rrënjësore në drejtoritë që kanë marrë përsipër, sidomos në aspektin e aradimit zyrtar ku janë treguar dorëlëshuar", - shkroi Gjetani. Sipas tij, administrata në Kurbin po gëlon nga militantët e paaftë, ndërsa edhe ata pak specialistë që kishin mbetur në këtë zonë janë zëvendësuar.



- PARTITË QË PRITET TË FIRMOSIN PËR KOALICIONIN ME PS**
- ▶ Partia Socialiste
 - ▶ Partia Social Demokratike
 - ▶ Partia Demokratcia Sociale
 - ▶ Aleanca Popullore
 - ▶ Partia Socialiste e Moderuar
 - ▶ Aleanca Demokratike
 - ▶ Partia e Gjelbër
 - ▶ Partia e Unitetit Kombëtar
 - ▶ Partia G99
 - ▶ Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
 - ▶ Partia Ardhmëria Shqiptare
 - ▶ Partia Për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve
 - ▶ Partia Socialpunëtore e Shqipërisë
 - ▶ Partia e Reformave Demokratike Shqiptare
 - ▶ Partia e të Drejtave të Mohuara
 - ▶ Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane
 - ▶ Partia e Punës së Shqipërisë
 - ▶ Partia Komuniste e Shqipërisë - 8 Nëntori
 - ▶ Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet
 - ▶ Partia Kristiandemokrate
 - ▶ Partia Lëvizja Punëtorë Shqiptarë
 - ▶ Minoriteti Etnik Grek për të Atdhmen
 - ▶ Partia e Çështjeve Shqiptare
 - ▶ Partia Demokratike e Re Europiane
 - ▶ Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve
 - ▶ Partia Fronti i Majtë

marrë pëlqimin e drejtuesve socialistë dhe tashmë të gjithë aleatët janë lajmëruar që të martën të zhvillojnë takime publike, ku do të nënshkruajnë edhe marrëveshjen e bashkëpunimit dhe dokumentin që do të dorëzohet në KQZ, ku shprehet vullneti për të qenë pjesë e një koalicioni. Megjithatë nuk bëhen të ditura shumë

detaje në lidhje me përmbytjen e këtyre dokumenteve dhe formulën e bashkëpunimit, mësohet se PS-ja në bazë të peshës specifike që ka secila forcë në elektorat dhe kjo bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme, të bëjë edhe përfshirjen e emrave të veçantë në vendet e sigurta në listën e kandidatëve për anëtarë të këshil-

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Zhvillohet ankandin e parë për pasuritë co.be.in SHPK :

1) a) nr.26/106+116, vol.51, fq.242, sip=72 m²; b) Njësi shërbimi nr.26/187-N8/2, vol.56, fq.121, sip=20 m²; c) nr.26/106+125, vol.52, fq.1; d) nr.26/187+19, vol.52, fq.58 (sip=110 m²);
2. Çmimi fillestar (për pasuritë e përcaktuara në pikën 1) për njësinë e shërbimit do të jetë 1600 euro/m², ndërsa për tre (apartamente) pasuritë e tjera do të jetë 360 euro/m²;
Pallati CO.BE.IN, VLORE (përballë Teatrit)
Ankandi zhvillohet më datë 02.5.2019 pranë zyrës përbarimorë "BEST 2010"
Me adresë : Sella; prapa Prokurorisë së Rrethit Durris
Mobile: 06920 756 44, Phone/Fax: 052 22 6000
Web: <http://www.përbarues.al> www.përbarues.al

Shitje me Ankand të Dytë nga Studio Perbarimorë L.D.C

"Trull" me sip. 1,874m² nga e cila 250 m² është ndertese, me Nr. Pasurie 134/33, vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur ne Levan, Fier, Regjistruar ne Z. R. P. P. Fier ne emer te Shoq. Aliljon shpk. Çmimi fillestar per shitje është 6.180.854 Leka.

Data e shpalljes 02.04.2019
Data e zhvillimit 07.05.2019 deri ne oren 16.⁰⁰

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimorë L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyti" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jondja Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e parë për pasuritë :

1- "ARE" me sipërfaqe totale 3.820,00 m², e ndodhur në Rrethi KAVAJE, QJF BAGO , Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, Zona Kadastrale: 1072, Numri i Pasurisë: 124/9, Vol. 3, Faqe 17, ne pronesi te Refat Rrahman Estrefi (Rifat Rrahman Istrefi)

Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 1,005,424(një milion e pesë mijë e katërqind e njëzet e katër) LEKË.
Ankandi i parë për pasuritë e mësipërme zhvillohet me datë 06.05.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbarueses gjyqësore private Jondja Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyti", vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0693831883 .

Kreu i PD-së komenton zhvillimet politike për gazetën sllovene "Delo"

Basha: Shqipëria në udhëkryq, të dënojmë politikanët e lidhur me krimin

"Vendin e shpëton vetëm një demokraci europiane"

Kreu demokrat, Lulzim Basha, në një intervistë dhënë për gazetën sllovene "Delo" shprehet se Shqipëria sot është në udhëkryq dhe se njerëzit kanë dalë në rrugë për ta shpëtuar atë nga sundimi, sipas tij, autokratik i Edi Ramës.

Cfarë mesazhi po përcjellin njerëzit në rrugët e Shqipërisë?

Mesazhi është shumë i thjeshtë "E duam Shqipërinë si e gjithë Europa". Duam të kemi zgjedhje të lira, shtet të së drejtës dhe drejtësi të barabartë për të gjithë. Tridhjetë vite pas rrëzimit të komunizmit, njerëzit shohin faktin se në Shqipëri nuk ka një shtet të së drejtës, por një shtet të kapur. Këtë radhë jo nga tirani ideologjike, por nga sundimi autokratik që ka uzurpuar të gjitha pushtetet.

Ku është sot Shqipëria?

Në udhëkryq. Është e vërtetë se shumë kemi arritur tridhjetë vitet e fundit, por tani duhet të çlirohemi nga autokracia. Duhet të ndjekim rrugën drejt Bashkimit Europian, e cila është aspiratë e 95% të shqiptarëve. Atje mund të arrijmë vetëm përmes rrugës europiane, jo me gënjeshtër, intriga dhe mospranim të rregullave të demokracisë. Duhet së pari të dënojmë politikanët që janë të lidhur me krimin e organizuar. Kjo duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë. Për këtë duhet t'i çlirojmë duart drejtësisë që të bëjë punën e saj dhe së dyti, përcaktime të qarta ligjore për të nxjerrë përgjithmonë nga politika personat e lidhur me krimin. Në Shqipëri kemi një rreth të ngushtë njerëzish, që kanë përqendruar në duart e tyre të gjithë vendimmarrjen politike dhe ekonomike dhe s'mendojnë aspak për shumicën e popullit në Shqipëri.

Po thoni fjalë goxha të mëdha, të cilat zakonisht politikanët opozitarë i harrojnë sapo vijnë në pushtet...

Pikërisht, për këtë arsye Shqipëria duhet të ndryshojë që nga themeli, që nga organizimi i saj juridik. Drejtësia nuk mund të mbetet më në dëshirat e qeverive, ligji nuk duhet të jetë monopol i të fortëve dhe të pasurve, por shqiptarët duhet të kenë akses të barabartë në sistemin e drejtësisë. Prej më shumë se një viti vendi s'ka Gjykatë Kushtetuese. Në Shqipëri mbizotërojnë klane të krimit të organizuar, që i kanë shtrirë lidhjet e tyre që nga Amerika Latine, Amerika e Veriut, Azia e deri në zemër të Europës. Dhe në vend që të ndiqen, të arrestohen, të vihen para



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

DREJTËSIA

Pikërisht për këtë arsye, Shqipëria duhet të ndryshojë që nga themeli, që nga organizimi i saj juridik. Drejtësia nuk mund të mbetet më në dëshirat e qeverive, ligji nuk duhet të jetë monopol i të fortëve dhe të pasurve, por shqiptarët duhet të kenë akses të barabartë në sistemin e drejtësisë. Prej më shumë se një viti vendi s'ka Gjykatë Kushtetuese. Në Shqipëri mbizotërojnë klane të krimit të organizuar, që i kanë shtrirë lidhjet e tyre që nga Amerika Latine, Amerika e Veriut, Azia e deri në zemër të Europës.

drejtësisë kriminelët, këta po fitojnë gjithmonë e më shumë ndikim politik, për shkak të lidhjeve me politikën, duke i zgjeruar edhe më tej "bizneset" e tyre.

Në përgjithësi, kur dikush bën shumë premtime dhe premtion shumë ndryshe, ndodh që problemet riciklohen...

Prandaj synojmë që në këtë ndryshim t'i përfshijmë të gjithë ata që kërkojnë të ndjekim ëndrrën europiane dhe që fuqia e vendimmarrjes t'u kalojë qytetarëve. Kjo do të bëhet duke inkurajuar gjithnjë e më shumë konkurrencën, si dhe njerëzit me ide.

Krimi i organizuar nuk është i lehtë për t'u larguar, ai gjithnjë do të kërkojë lidhje të reja...

Përcaktues është vullneti politik. Për këtë shkak, më shumë se në luftën politike

duhet të jemi të përqendruar edhe të përcaktimi i rregullave, ligjeve, dhe ajo që është më e rëndësishme, ndëshkueshmërisë. Gjatë gjithë kohës, formacioni ynë politik ka qenë i angazhuar në luftën kundër krimit të organizuar. Në vitin 2015 i imponuam qeverisë miratimin e një ligji, që ndalon zgjedhjen në funksione publike të personave të përfshirë në krime apo që lidhjet e të cilëve me krimin e organizuar, janë të provuara. Politikanët që janë të lidhur me krimin e organizuar duhet të dënohen, jo të shpërblehen.

Po pse kriminelët kanë zbuluar parajsën e tyre në Shqipëri?

Krimi shkon gjithmonë atje ku institucionet publike janë të dobëta dhe ku politika është e gatshme të sakrifikojë të mirat publike për interesat personale. Aty ku drejtuesit

nuk mendojnë për investime në arsim e shëndetësi, por mendojnë të kenë kontroll total mbi shtetin, policinë dhe gjyqësorin. Prandaj, duhet të investohemi shumë në forcimin e institucioneve shtetërore dhe inkurajimin e konkurrencës politike.

Sa do të jenë të rëndësishme përgjithmonë zgjedhjet për Parlamentin Europian në muajin maj?

Është e rëndësishme që BE-ja t'i mbetet besnike Samitit të Selanikut mbi perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Por gjithsesi, e rëndësishme është që të përqendrohemi te vetja jonë, te plotësimi i kriterëve për anëtarësim, në mënyrë që të rinjitet tanë, me ide në ekonomi, kulturë e arsim, t'i realizojmë në vendin tonë e jo të detyrohemi të emigrojmë në shumicë, siç ndodh aktualisht.

Para zgjedhjeve europiane po shtohet frika se po forcohen të djathtat sovraniste në Parlamentin Evropian...

Partia Demokratike e Shqipërisë është themeluar nën aspiratën që Shqipëria të bëhet vend anëtar i NATO-s dhe i Bashkimit Europian. Tashmë jemi anëtarë të NATO-s. Po ashtu, kemi marrë statusin kandidat për t'u

ZGJIDHJA

"Duhet të ndjekim rrugën drejt Bashkimit Europian, e cila është aspiratë e 95% të shqiptarëve. Atje mund të arrijmë vetëm përmes rrugës europiane, jo me gënjeshtër, intriga dhe mospranim të rregullave të demokracisë. Së pari duhet të dënojmë politikanët që janë të lidhur me krimin e organizuar. Kjo duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë. Për këtë duhet t'i çlirojmë duart drejtësisë që të bëjë punën e saj dhe së dyti, përcaktime të qarta ligjore për të nxjerrë përgjithmonë nga politika personat e lidhur me krimin".

KRIMINELËT

"Krimi shkon gjithmonë atje ku institucionet publike janë të dobëta dhe ku politika është e gatshme të sakrifikojë të mirat publike për interesat personale. Aty ku drejtuesit nuk mendojnë për investime në arsim e shëndetësi, por mendojnë të kenë kontroll total mbi shtetin, policinë dhe gjyqësorin. Prandaj duhet të investohemi shumë në forcimin e institucioneve shtetërore dhe inkurajimin e konkurrencës politike".

futur në BE. Shtetasit shqiptarë mund të udhëtojnë prej 9 vitesh pa viza brenda hapësirës Shengen. Por, fatkeqësisht, me marrjen e pushtetit nga pala tjetër në 2013-ën, në Shqipëri procesi i integrim-it ka ngecur dhe nuk po ndërmerren reformat e duhura.

Por trendi i së djathtës europiane mbetet përforcimi i nacionalizmit dhe jo integrimi i mëtejshëm...

Ndjek me preokupim zhvillime të tilla. Detyra jonë është të ndërtojmë klimën e besimit dhe të plotësojmë kushtet e kërkuara për anëtarësim në BE, anëtarësimi që vendit tim do t'i sjell shumë përfitime si në lëvizjen e lirë të njerëzve, ashtu edhe të kapitalit, punës, ideve dhe heqjes së shumë pengesave e kufijve. Unë jam i bindur se në momentin që do të arrijmë të ndërtojmë Europën në shtëpinë tonë, do të arrijmë të kemi mbështetjen e vendeve anëtare të BE-së për të ecur me shpejtësi në rrugën jonë të lehtë të anëtarësimit.

Ju po bashkëpunoni ngushtë me Donald Trump, megjithëse ai e ka vlerësuar Bashkimin Europian si kërcënim për SHBA?

Gjithnjë kujdesemi për kontakte sa më të mira me SHBA-të, pasi me mbështetjen e

Amerikës jemi bërë anëtar të NATO-s. Të mos harrojmë edhe ndihmën që Shtetet e Bashkuara kanë dhënë në pavarësimin e Kosovës. Por, bashkëpunimi me SHBA-të nuk përjashton në asnjë mënyrë dëshirën tonë që të jemi anëtarë me të drejta të barabarta në Bashkimin Evropian.

Disa politikanë, kolegë tuaj, po kapen pas pengesave teknike dhe një diskursi ksenofob për të përfituar politikë.

Dritëshkurtësia në lidhje me problemet e migracionit të pakontrolluar ka sjellë edhe zgjidhje dritëshkurtëse. Politikanët nuk po i identifikojnë arsye e vërteta të migracionit, prandaj edhe strehohen tek një diskurs ksenofob, që nuk i shërben askujt.

Keni ndonjë mendim për idenë e bashkimit apo "Shqipërinë e madhe"?

Shqipëria dëshiron të anëtarësohet në Bashkimin Europian. Po ashtu, të njëjten aspiratë kanë edhe Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Kësaj, jam i bindur se të gjithë shqiptarët në këto pesë vende do të bëhen bashkë si anëtarë të BE-së.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
 Rr. "Fishtë Dard", Kompleksi K&A 2, Kulla 5, K. 1, Tiranë
 Web: www.3h.al Email: shg@3h.al yaho.com 0692202971

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.23.04.2019 deri ne dt. 02.05.2019 persendin e luajtshem- gjysem rismorko, marka Shmitz, Spr me Targa AER 936, me crim fillestar 199,824.00 Leke autometjetin gjysem rismorko marka general trailers, F34 me Targa AER 360 me crim fillestar 169,850.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L
Ankandit zhvillohet ne zyrën permbarimore ne daten 02.05.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Zyra Permbarimore Fier me permbarus gjyqësor Arian CEPELE me adresë Lagja "29 Nentori"godina e Gjykatës Fier nga mbrapa, njofton se më date 18.04.2019-02.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandit i 1-rë për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr. 732 / ZK 2890, me sipërfaqe 1124 m2 me adresë Patos,Fier, në pronësi Z.Haxhi S.Gjyle Rrapaj me vlerë filltare në ankand 4 960 000 (katërmilëneqëndëgjatëdhjetë mijë) LEK .

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 697262655.

EPISA SHOQËRIA PËRMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A"
 SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :

"Ullishte (Trulli)" me sip. 14,700 m2, Nr. Pasurie 56/3, Vol.29, Fq.15, ZK 8605, i ndodhur ne Vlorë 5, Vlorë dhe "Objekt karabina 4 Kat + 1 Kat bodrum" me sip. 1,262 m2, Nr. Pasurie 56/3-ND, ZK 8605, i ndodhur ne L 11 Janari, Vlorë ne pronesi te Shkollës Internacionale shpk. Keto pasuri jane hipotekuar ne favor te Banka ProCredit sha. Çmimi me të cilin fillon ankandit është 3,135,524 Euro. Ankandit zhvillohet date 09.05.2019 ora 16.00 në adresen Rr."1, Qemali", Pall. "Fratar", K.6, Tiranë.
Per cdo informacion mund te kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne web www.epsa.al.

Takimi do të mbahet me ftesë të kancelares gjermane dhe presidentit francez

Samiti i Berlinit, kancelarja Merkel takim me kryeministrin Rama

Shqipëria dhe Maqedonia presin përgjigje pozitive për negociatat

Kerër e shteteve të Ballkanit Perëndimor do të mbledhen së bashku sot në Berlin, në kuadër të Samitit të Berlinit. Takimi organizohet nën kujdesin dhe praninë e kancelares gjermane, Angela Merkel dhe presidentit francez, Emmanuel Macron dhe do t'u kushtohet kryesisht zhvillimeve integruese të vendeve të Ballkanit dhe zgjidhjes së problematikave që ekzistojnë sot si në politikën e brendshme të vendeve, ashtu edhe ato ndërmjet shteteve. Gjatë ditës së djeshme, kancelarja gjermane publikoi axhendën e këtij samiti, ku ndërmjet të tjerave do të ketë edhe një takim të veçantë me Kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Me konkretisht, sipas kësaj axhendë, kancelarja Merkel bën të ditur se do të presë në një takim të veçantë Kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe më pas thajse në të njëjtin format do të presë dhe të zhvillojë një bisedë edhe me kryeministrin shqiptar, Edi Rama. "Të hënën pasdite, një takim i Ballkanit Perëndimor do të mbahet në Kancelarinë Federale me ftesë të Kancelares Federale dhe Presidentit francez, Emmanuel Macron. Së pari, kancelarja do të presë Kryeministrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Zoran Zaev, për një bisedë", - thuhet në njoftimin e publikuar nga zyra e kancelares Merkel. Pra, siç edhe shihet nga axhenda jo më kotë kancelarja Merkel ka rezervuar takime të veçanta me dy kryeministrat Zaev dhe Rama, kjo pasi ata janë përfaqësuesit e dy vendeve që presin përgjigje sa i përket procesit të hapjes së negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian. Ndaj, pritet që gjatë këtyre takimeve, kancelarja t'i bëjë të ditur verdiktin e BE-së lidhur me këtë proces. Pas bisedës që do të zhvillojë me shefin e qeverisë shqiptare, Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel do të vijojë më pas diskutimet me Presidentin e Francës, Emmanuel Macron, bisedë kjo, e cila do të pasohet edhe me një konferencë të përbashkët shtypi. "Në vijim, kancelarja do të mbajë një diskutim të shkurtër dypalësh me Presidentin francez, Emmanuel Macron, pasuar nga deklaratat për shtyp nga të dy liderët. Pas ardhjes së shefave të shtetit dhe qeverive të Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Malit të Zi, Serbisë, Sllovenisë dhe Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, do të fillojë takimi i Ballkanit Perëndimor", - thuhet në njoftim. Samiti i Berlinit pritet të jetë një për-



AXHENDA

"Një takim i Ballkanit Perëndimor do të mbahet në Kancelarinë Federale me ftesë të Kancelares Federale dhe Presidentit francez, Emmanuel Macron. Së pari, kancelarja do të presë Kryeministrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Zoran Zaev, për një bisedë", - thuhet në njoftimin e publikuar nga zyra e kancelares Merkel.

ballje e fortë mes Kosovës dhe Serbisë. Sipas asaj që raportojnë mediat gjermane, thuhet se Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, do t'i kërkojë homologut të tij serb njohjen e pavarësisë pa asnjë kusht. Dy udhëheqësit më të lartë të Kosovës nuk presin që Samiti i Berlinit të sjellë një proces të ri, por sipas tyre, në takimin e nivelit të lartë do të kërkohen mundësi të reja për arritjen e një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Presidenti Hashim Thaçi para nisjes për në Berlin tha se në ditët e fundit ka vazhduar konsultat me partnerët ndërkombëtarë për Samitin e Berlinit, duke e mirëpritur "rritjen e angazhimit të Gjermanisë dhe Francës rreth Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, si dhe Kosovës në veçanti". Gjithashtu, ai u shpreh se nga ky takim Kosova pret mbështetje për liberalizimin e vizave.

Rama: Me një profesion do ta keni më të lehtë për punë

Start Smart" është një instrument i rëndësishëm për profilizimin apo riprofilizimin e çdo punëkërkuetit të papunë, me qëllim orientimin sa më të mirë për punë dhe profesion. Kryeministri Rama, i shoqëruar nga zëvendësiministria e Ekonomisë dhe Financave, Dajna Sorensen ishin në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional në Elbasan ku po trajnohen 451 kursantë. Kursantët e trajnuar pas përfundimit të kursit orientohen drejt punësimit, ose drejt formimit profesional të mëtejshëm. Kryeministri Edi Rama theksoi se marrja e një zanati është një mundësi më e mirë për t'u punësuar. "Kjo është një gjë e domosdoshme, sepse e keni parë vetë, që shkon të kërkosh punë e ju thonë çfarë di të bësh e ngre supet. Ndërkohë që këtu, duke marrë këto aftësitë të bazë e duke pasur dhe njohuri profesionale bazë, do ta keni shumë më të lehtë për t'u integruar në tregun e punës dhe duke qenë edhe më të kualifikuar, patjetër që edhe pagat do të jenë më të mira që në fillim", - tha kryeministri Rama, ndërkohë që synimi për këtë qendër formimi është profilizimi i saj drejt industrisë, ku edhe bizneset në këtë rajon kanë më tepër nevojë.

Mediat gjermane veçojnë Maqedoninë: E meriton një përgjigje pozitive

Dy nga mediat më të njohura gjermane "Frankfurter Allgemeine Sonntagszeitung" dhe "Deutsche Welle", i kanë kushtuar dhe një analizë të thellë takimit të Berlinit të thirrur nga kancelarja Angela Merkel dhe Presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Prestigjiozja "Frankfurter Allgemeine Sonntagszeitung" thekson se të gjashta vendet pjesëmarrëse presin të anëtarësohen në BE, por sipas saj, askush prej tyre nuk është gati. Ajo veçon Maqedoninë e Veriut, për të cilën thekson se ka një qeveri reformatore. "Këto gjashtë vende duan të anëtarësohen në BE, por asnjëri nuk është vërtet i gatshëm për këtë. Integrimi i mëtejshëm i tyre në BE do të ishte sinjal i gabuar. Me një përjashtim: Maqedonia e Veriut ka një qeveri reformatore, e cila për ëndërrin europi-



ane ka bërë kompromise të guximshme dhe madje ka ndërruar edhe emrin e shtetit për t'i dhënë fund ngatërresës së vjetër me shtetin anëtar të BE-së, Greqinë. Fillimi i negociatave për anëtarësim do të ishte një mirënjohje e duhur për aq shumë guxim", - thuhet në këtë artikull. Pra, me sa duket gazeta që ka burime të forta në Berlin nuk e për mend fare Shqipërinë, duke veçuar fqin-

jin tonë me të cilin jemi në të njëjtën paketë. Ndërkohë që edhe "DW" në analizën e vet thekson se situata për çështjen e integritimit nuk është shumë e favorshme, për shkak edhe të zhvillimeve në Francë. "Franca nuk dëshiron ta zërë fare në gojë çështjen e zgjerimit të BE-së në prag të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, prandaj kjo nuk do të jetë temë e samitit vetë. Por, si për kryeministrin shqiptar, Edi Rama, ashtu edhe për Kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, janë paraparë takime bilaterale me kancelaren Angela Merkel, para fillimit të takimit. Temë këtu do të jetë çelja e negociatave të anëtarësimit në BE. Merkel dëshiron të theksojë kështu rëndësinë që u jep Gjermania këtyre dy vendeve dhe perspektivës së tyre në BE", - thuhet në analizën e "DW".

Meta: Më shumë bashkëpunim dhe harmoni për të mirën e përbashkët

Besimtarët ortodoksë, ashtu si në të gjithë botën, edhe në Shqipëri kanë kremtuar dje ditën e Pashkës. Nuk munguan në këtë ditë as urimet e politikanëve, të cilët bënë apel për më shumë mirëkuptim dhe bashkëpunim për të mirën e përbashkët të të gjithë shqiptarëve. Presidenti i Republikës, Ilir Meta vizitoi dje Katedralen "Ngjallja e Krishtit" në Tiranë, ku u prit nga Kryepeshkopi i Shqipërisë, Portumturia e Tij Anastasi dhe klerikë të tjerë të Kishës Ortodokse Autocefale të Shqipërisë. Presidenti Meta uroi drejtuesit e lartë të KAOSH-it dhe të gjithë besimtarët ortodoksë shqiptarë, duke shprehur bindjen se nëpërmjet besimit në Zot e me vlerat më të mira shpirtërore dhe bashkëpunim me njëri-tjetrin, shpresat për një jetë më të mirë do të ringjallen tek të gjithë sh-



qipatarët. "Kjo është një ditë e jashtëzakonshme kundër dëshpërimit dhe fatalitetit, si dhe e shpresës dhe e entuziazmit për një të ardhme më të mirë. Është një ditë e triumfit të jetës mbi vdekjen, të së mirës mbi të keqen, të shpresës mbi frikën dhe mbi pasigurinë. Është një ditë që na bashkon të gjithëve e që na ndihmon të reflektojmë për më shumë bashkëpunim dhe harmoni, për të mirën e përbashkët", - u shpreh Presidenti Meta. Ndërkohë që

politikanët e tjerë zgjedhën që urimet e tyre t'i përcillnin nëpërmjet rrjeteve sociale. Kreu i qeverisë zgjodhi pamjen e kishës së Marmiroit në Orikum të Vlorës për të përcjellë urimin e tij. "Me këto pamje nga kisha e Marmiroit në Orikum të Vlorës, ju uroj Pashkë sa më të gëzuar", - theksoi kryeministri Rama. Ndërsa kreu demokrat shkroi se kjo festë e shenjtë kremton triumfin e jetës mbi vdekjen, të shpresës dhe dritës mbi të keqen.

Eksperti: Të themi të vërtetën në vendin e gënjeshtrës, milionat që janë vjedhur

Dr. Klodian Muço: Sugjerime për të shpëtuar ekonominë në Shqipëri

"Të rritet eksporti dhe të investohet në arsim"

Reformat ekonomike mund të jenë një stimulues shumë i mirë në rritjen e PBB-së, çka do të sillte edhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", dr. Klodian Muço, ekspert i ekonomisë, njëkohësisht profesor i shkencave ekonomike në universitetin "Aleksandër Moisiu" tregon se shpenzimet që ka bërë qeveria në kundërshtim me ligjin arrijnë vlerën e miliona eurove dhe ndikojnë drejtpërdrejt në buxhetin e shtetit. Ai shpreh se papunësia është në rënie për arsye të vetme të largimit të të rinjve nga vendi, të cilët kanë humbur shpresat për të ardhmen. Muço jep disa rekomandime sesi mund të arrihet zhvillimi i ekonomisë në Shqipëri.

Sa të rëndësishme janë reformat ekonomiko-institucionale për zhvillimin ekonomik të vendit?

Asnjë eksponent i rëndësishëm në politikë dhe asnjë përfaqësues i shoqërisë civile nuk ka tentuar të bindë elektoratin e vet se nevojiten masa dhe reforma ekonomiko-institucionale drastike për të stimuluar rritjen e PBB-së, të shoqëruar me zhvillim ekonomik.

Çfarë është PBB-ja dhe cili është roli i saj?

PBB-ja në fakt nuk është gjithçka në jetë, është një tregues i mirëqenies së një vendi, i cili shërben shpesh për të treguar çfarë drejtimi duhet të marrim. Që PBB-ja të rritet, duhet të prodhohen të mira dhe shërbime në një vend, pra të kemi një rritje komplekse të prodhimit. Por ky i fundit rritet vetëm nëse ka një kërkesë për këto të mira, pra duhet që prodhim të konsumohet.

Si mund të stimulohet kërkesa për të mira dhe shërbime në Shqipëri?

Si bazë kërkesë shërben gjithmonë: rritja e të ardhurave reale dhe optimizmi për të nesërmen, rritja e shpenzimeve publike, rritja e investimeve private, rritja e eksporteve. Nisim nga e para, shqiptarët kanë çdo ditë e më tepër më pak para për të shpenzuar. Rrogat reale janë në rënie. Qeveria për të ulur evazionin dhe për të rritur të ardhurat fiskale, rriti bazën e tatueshme për rrogat minimale e nga ana tjetër uli tatimin mbi dividendin.

Sa janë shpenzimet që ka bërë qeveria në kundërshtim me ligjin?

Qeveria nuk u preokupua asnjëherë që për 2018-ën u dhanë 85 milionë euro



Dr. Klodian Muço

ROLI I PBB

PBB-ja në fakt nuk është gjithçka në jetë, është një tregues i mirëqenies së një vendi, i cili shërben shpesh për të treguar çfarë drejtimi duhet të marrim. Që PBB-ja të rritet, duhet të prodhohen të mira dhe shërbime në një vend, pra të kemi një rritje komplekse të prodhimit. Por ky i fundit rritet vetëm nëse ka një kërkesë për këto të mira, pra duhet që prodhim të konsumohet.

dëmshpërblime për heqje të padrejta nga puna. Nuk u preokupua as për gati 800 milionë euro shkelje që gjeti KLSH-ja (në fakt këto fenomene kanë vite që janë prezente në Shqipëri, nuk është një problem që u shfaq vetëm në 2018-ën). Praktikisht edhe pse të gjitha këto para përbëjnë rreth 1/5 e buxhetit të shtetit, çuditërisht asnjë nuk u procedua penalisht dhe të futej në burg.

Në çfarë raporti qëndron papunësia me numrin e shqiptarëve që largohen nga vendi?

Një aspekt tjetër është papunësia. Nëse do shohim përqindjen e papunësisë, kjo e fundit është në rënie. Në realitet, kjo rënie e papunësisë vjen si pasojë e rritjes së emigracionit, pasi shumica e të rinjve por jo vetëm, nuk besojnë më tek e ardhmja e këtij vendi. E si mund të besohet, kur çdo ditë mediat

shqiptare japin raste konkrete që po helmohen shqiptarët me perime, fruta, mish me hormone e pesticide të ndaluara! Apo që shpesh blejmë ilaçe të skuadua. Ndërsa nga institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore s'ka pasur as dorëheqje, as shkarkime nga puna. Si ka mundësi që s'ka një drejtor rajonal në këtë vend që të mos të jetë militant partie? Si ka mundësi që shumë prej tyre janë me diploma të blera nga universitetet e mbyllura. Si ka mundësi që për të gjetur një vend pune në administratën shtetërore nuk ka një kriter note apo preferencë për ata që kanë mbaruar në universitetet të mira? Pse nuk promovohet cilësia?

Si ndikojnë faktorët e sipërpërmendur në PBB?

Këto janë disa fakte që tregojnë më së miri se pa

bërë ndryshime drastike, nuk mund të kemi një rritje drastike të PBB-së falë rritjes së kërkesës së brendshme e që nuk mund të frenojmë ikjen e të rinjve.

Përsa i përket rritjes së shpenzimeve publike, Shqipëria ka shumë kufizime buxhetore për të respektuar. Shpenzimet publike jo vetëm që nuk mund të rriten në vitet në vijim, por përkundrazi ato edhe mund të tkurren, pasi vendi ynë po jep çdo shërbim apo investim në infrastrukturë me koncesion, ku financimi i tyre në të ardhmen po bëhet gjithmonë e më impenjatv për vendin.

Cilat janë disa nga zgjidhjet që ju si ekspert rekomandoni për rritjen e ekonomisë së Shqipërisë?

Për të zgjidhur këtë gjë nevojitet një klasë politike e re, ku misioni i saj të jetë mbrojtja e pronave publike dhe interesat e qytetarëve. Duke prishur shumë nga koncesionet që zhvatit qytetarët e shesin shërbimet e tyre shumë shtrenjtë. Ku jo në pak raste nuk kanë sjellë vlerë të shtuar për qytetarët. Një formë tjetër e rëndësishme për të stimuluar zhvillimin ekonomik është rritja e investimeve private. Në fakt, ndërmarjet investojnë kur ekonomia "lëviz", nëse nuk ka kërkesë, nuk mundet të ekzistojë as oferta.

Sa mund të ndikojnë investimet e huaja në këtë

RAPORTI I PAPANËSISË

Një aspekt tjetër është papunësia. Nëse do shohim përqindjen e papunësisë, kjo e fundit është në rënie. Në realitet, kjo rënie e papunësisë vjen si pasojë e rritjes së emigracionit, pasi shumica e të rinjve por jo vetëm, nuk besojnë më tek e ardhmja e këtij vendi. E si mund të besohet, kur çdo ditë mediat shqiptare japin raste konkrete që po helmohen shqiptarët me perime, fruta, mish me hormone e pesticide të ndaluara! Apo që shpesh blejmë ilaçe të skuadua.

RITJJA E EKONOMISË

Për të zgjidhur këtë gjë nevojitet një klasë politike e re, ku misioni i saj të jetë mbrojtja e pronave publike dhe interesat e qytetarëve. Duke prishur shumë nga koncesionet që zhvatit qytetarët e shesin shërbimet e tyre shumë shtrenjtë. Ku jo në pak raste nuk kanë sjellë vlerë të shtuar për qytetarët. Një formë tjetër e rëndësishme për të stimuluar zhvillimin ekonomik është rritja e investimeve private. Në fakt, ndërmarjet investojnë kur ekonomia "lëviz", nëse nuk ka kërkesë, nuk mundet të ekzistojë as oferta.

proces?

Ne jemi një vend i varfër, me taksa të larta. Investitorët e huaj nuk kanë më interes të vijnë në Shqipëri, të përballen me burokraci pa fund e me taksa të larta. Kur ka vende si Hungaria, pjesë e BE-së që po redukton taksat për investimet e reja duke arritur të jenë sa 2/3 e taksave tona. Shkojnë në Serbi apo Kroaci, ku të ofrojnë edhe para vetëm e vetëm që investitorët e huaj të hapin vende të reja pune.

Në Shqipëri aktualisht lulëzon vetëm ndërtimi në qendër të Tiranës, ku çmimi shkon 2000-3000 euro për metër katror. Dmth., jashtë çdo standardi për rrogat mesatare që ekzistojnë aktualisht në Shqipëri. Pra, nuk po ndërtohet për 90% të popullsisë.

Si mund të rritet eksporti dhe sa pesë ka arsimi në këtë rritje?

Një formë tjetër për të stimuluar rritjen ekonomike, e cila është edhe më e vështira për Shqipërinë, është rritja e eksporteve dhe reduktimi i importeve. Për të bërë këtë, Shqipërisë i nevojitet të rriti investimet në arsim dhe të reduktojë burokratitë. Librat për ciklin fillor dhe atë nëntëvjeçar le t'i shtypë vetë ministria, s'ka pse "bën biznes" edhe me njohuritë e brezave të ardhshëm. Vitet e fundit po shihet që po ikën ditaditës autonomia universi-

tare. Futja e bordeve dhe pjesëmarrja e militantëve në to është antidropive. E dyta, nevojiten më tepër lehtësira nga pikëpamja fiskale për kompanitë e huaja "software house" që vijnë në Shqipëri. Nevojitet hapja e inkubatorëve të biznesit, promovimi dhe financimi i ideve të reja. Nevojitet po ashtu të investohet në turizëm, të promovohen bukuritë shqiptare. Investimi nga ana e shtetit duhet të jetë në infrastrukturë, ujësjellës dhe pastrimin e ambienteve publike.

Për të konkluduar, mund të themi që t'u zhvilluar ekonomikisht, kemi nevojë për një klasë politike që të jetë po aq e denjë sa edhe ajo e Tanzanisë apo Xhamajkës. E them këtë me gjithë respektin për tanzanezët apo xhamajkanët. Por, politikanët tanë janë ata që kemi parë të gjithë. Të gjithë që lëvizin me makinë të shtrenjta, kanë shumë shtëpi e prona, shkollonjë fëmijët e tyre jashtë, i punësojnë të afërmit e tyre në pozicionet më të mira të administratës publike dhe qytetarëve u thonë se ata do gjë e kanë arritur me kursim dhe me zotësi. Kur janë në opozitë thonë do futim në burg hajdutët, duam zgjedhje të lira, votim elektronik, ndërsa kur vijnë në pushtet harrojnë çdo kërkesë apo premtim.

PENSIONET KRITERET

ISSH: Cilat janë kushtet e përfitimit të pensionit të pleqërisë, dokumentacioni

Sa do të rritet mosha e daljes në pension për 5 vitet në vijim

Tabelat e plota me ndryshimet për burrat dhe gratë

Mosha e daljes në pension do të pësojë rritje nga viti në vit, në bazë të legjislacionit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Prej janarit të 2019-ës, ashtu siç parashikohet në ligj, ka pasur ndryshime përsa i përket moshës së daljes në pension për të gjithë individët që kanë minimumi 15 vite pune me kontribute. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot moshën e daljes në pension për 2019-ën si dhe 2020-ën. Aktualisht për vitin 2019-të, mosha e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e 10 muaj (rritet për çdo vit me 2 muaj deri në vitin 2056 që arrin në 67 vjeç). Ndërkohë sipas kësaj llogaritjeje, mosha e daljes në pension për gratë në 2020-ën do të jetë do të jetë 61 vjeç, ndërsa në 2021 do të jetë 61 vjeç e dy muaj. Ndërkohë, burrat duhet të kenë mbushur moshën 65 vjeç, në mënyrë që të përfitojnë pagesën e pensionit të pleqërisë (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të arritur në 67 vjeç në vitin 2056). Në bazë të reformës së vitit 2014-të, masa e përllogaritjes së pensionit varet nga vitet e punës dhe paga, pra pensioni është produkt i viteve të sigurimit dhe pagës mbi të cilin janë paguar kontributet. Sa më shumë vite të ketë aplikanti dhe sa më e lartë të ketë qenë paga e tij, aq më e lartë do të jetë masa e përfitimit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se vjetërsia e plotë kontributeve për të dyja gjinitë është 35 vite e 3 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit, për të arritur me 40 vite në vitin 2029. "Personat e siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të këtij ligji", theksohet në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për sa i përket pensionit të pleqërisë në vendin tonë. Ndërkohë, personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar deri tri vite para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92 kur kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92; apo nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të



Për burrat						Për gratë					
Vitet	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vitet	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35	55v	35	60v	35	60v
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m	56v	35	60v 2m	35v 4m	60v 2m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m	56v 6m	35	60v 4m	35v 8m	60v 4m
01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v	57v	35	60v 6m	36v	60v 6m
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m	57v 6m	35	60v 8m	36v	60v 8m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m	58v	35	61v	37v	61v
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v	58v 6m	35	61v 2m	37v 4m	61v 2m
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m	59v	35	61v 4m	37v 6m	61v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m	59v 6m	35	61v 6m	37v 8m	61v 6m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v	60v	35	61v 8m	38v	61v 8m
01.01.2024 - 31.12.2024	65v 6m	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m	60v 6m	35v 6m	61v 8m	38v 4m	61v 8m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v 12m	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m	60v 12m	36v	61v 10m	38v 6m	61v 10m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v 18m	39v	65v	39v	65v	39v	61v	36v 6m	62v	39v	62v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v 24m	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m	61v 6m	37v	62v 2m	39v 4m	62v 2m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v 30m	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m	61v 12m	37v 6m	62v 4m	39v 6m	62v 4m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v 36m	40v	65v	40v	65v	40v	62v	38v	62v 6m	40v	62v 6m
01.01.2030 - 31.12.2030	65v 42m	40v 6m	65v	40v 6m	65v	40v 6m	62v 6m	38v 6m	62v 8m	40v 6m	62v 8m
01.01.2031 - 31.12.2031	65v 48m	40v 12m	65v	40v 12m	65v	40v 12m	62v 12m	39v	62v 10m	40v 6m	62v 10m
01.01.2032 - 31.12.2032	65v 54m	40v 18m	65v	40v 18m	65v	40v 18m	63v	40v	63v 2m	40v 6m	63v 2m
01.01.2033 - 31.12.2033	65v 60m	40v 24m	65v	40v 24m	65v	40v 24m	63v 6m	40v	63v 4m	40v 6m	63v 4m
01.01.2034 - 31.12.2034	65v 66m	40v 30m	65v	40v 30m	65v	40v 30m	63v 12m	40v	63v 6m	40v 6m	63v 6m

punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar. Ndërkaq, nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë të rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim. "Për të lindur e drejta për pension pleqërie, kërkohen dy kushte, që janë vjetër-

sia kontributive jo më pak se 15 vite kontribute dhe mosha, që për-

caktohet sipas tabelës së paraqitur në nenin 43 të ligjit (që ndryshon ne-

PERFITIMI
Për të përfutur pension pleqërie individ duhet të bazohet të kriteret, mosha dhe vitet e punës me kontribute. Domosdoshmërisht individ duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 10 muaj për gratë e mbi 65 vjeç për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi vetë ISSH-ja ka aktes mbi regjistrin themeltar të shtetasve.

rë nga 1 janari i 1994 e deri më sot. Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listëpagesat janë grumbulluar në arkivën e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individ ka punuar para vitit 1994, shërben librezë e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individ humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepet të dhënat individuale të personit, paraqet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar dhe pas kësaj duhet të shpjegojë që vetë personi në fjalë kërkon të pajiset me një dokument të ri, ku të konfirmohen të gjitha vitet e punës që individ ka kryer. Organet e sigurimeve shoqërore janë të detyruara ta marrin kërkesën deklarative dhe të vënë në dijeni qytetarin që duhet të presë jo më shumë se 60 ditë, derisa të bëhen të gjitha verifikimet e nevojshme mbi të gjitha punët që ka bërë personi. Dokumenti, pra librezë e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vullash apo publikatë librezë. Në momentin kur ka publikatë të librezës së punës, me siguri ka një "ngërc" e menjëherë duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listëpagesat që të vërtetojnë faktin që individ ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

**ni n 92).
KRITERET E PËRFITIMIT**

Për të përfutur pension pleqërie individ duhet të bazohet të kriteret, mosha dhe vitet e punës me kontribute. Domosdoshmërisht individ duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 10 muaj për gratë e mbi 65 vjeç për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi vetë ISSH-ja ka aktes mbi regjistrin themeltar të shtetasve. Megjithatë, qytetari duhet të dorëzojë një fotokopje të kartës së identitetit dhe në rastet kur pretendon të marrë kompensime të tjera që i bashkëngjiten pensionit, duhet të dorëzojë edhe dokumente të tjera si certifikata familjare për të verifikuar pjesëtarët e familjes. Kur individ mendon se ka 40 vite punë, duhet të paraqesë librezën e punës dhe dokumentin që vërteton pagat që ka mar-

NJOFTIMI PËR SHITJE ME ANKAND
Permbuesit gjyqësore Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat : "Trulli-Ndertesë" me sip. totale 202.5 m² dhe nga kjo ndertesë me sip.65 m², me Nr pasurisë 77834, vol 38, fq 125, ZK 6592 e ndodhur në Lagjen Partizani "Shkoder..." afshuar në favor të debitorit Izmir Hebojia.
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpeshkruar , është në vlerën : 9,120,000 (nentëmbilind e njëqind e njëzet mijë) leke .
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 05.05.2019 ora 16.16 në Zyren e permbuesit gjyqësore Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Parballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tirana Bank dega Shkoder në nr llogarie 0600-313839-100 CB

NJOFTIMI PËR SHITJE ME ANKAND
1.Permbuesit gjyqësore Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat : "Ndertesë njëkateshe industriale" me nr pasurie 1077ND , Volumi 24 , Fqje 143, me sipërfaqe ndërtimeore 1 235 m² , Zona kadastrale 8592, e ndodhur tek zona industriale e qytetit , pjesë e ish parkut të mallrave , Shkodere regjistruar në favor të Altin Salihi etj .
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpeshkruar , është në vlerën : 2,420,000 (njëzetë kater milione e dyqind e katerdhjetë mijë) leke .
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 03.05.2019 ora 16.16 në Zyren e permbuesit gjyqësore Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Parballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tirana Bank dega Shkoder në nr llogarie 0600-313839-100 CB .

Reagon deputeti: Në sistemin tonë juridik kemi probleme të thella

Vrasësi shqiptar ikën nga burgu britanik, është dënuar me 25 vite

Një shqiptar 43 vjeç, i quajtur Hektor Mahmutaj, i dënuar me 25 vjet burg në Britani për vrasjen e një fermeri në Shqipëri ka habitur autoritetet britanike me gjestin e tij. Mahmutaj ka marrë leje nga autoritetet britanike të burgut, por nuk është kthyer më në qeli. Autoritetet e shtetit në Britaninë e Madhe kanë mbetur të habitur me faktin se shqiptari nuk u kthyer më në burg, shkruan "Express.com.uk". Hektor Mahmutaj, 43 vjeç, ka hyrë në Britaninë e Madhe i fshehur në një kamion, ndërkohë që në Shqipëri ka një dënim në mungesë për vrasje. Në tetor të vitit të kaluar, gjykatësi Tan Ikram vendosi që ai të ekstradohej në Shqipëri. E pavarësisht se Mahmutaj kishte një sërë dënimesh në ishull, përfshi për zotërim armësh zjarri, ai u lirua me kusht. Duke qenë një shtetas jo i Bashkimit Europian, ai iu referua një tjetër gjykatësi për vendimin final. Sajid Javid la në fuqi vendimin në fund të vitit të kaluar, duke i hapur rrugë kështu ekstradimit. Por, tabloidët britanikë raportojnë tashmë se Mahmutaj ka shkelur lirinë me kusht dhe është arratisur. Vendndodhja e



Vrasësi shqiptar, Hektor Mahmutaj

tij nuk dihet. I dënuari për vrasje mohon akuzat, por ndërkohë nëse ekstradohet në Shqipëri, do të rigjykohej, për shkak se gjyqi i tij

fillestar është kryer në mungesë. Ndërkohë, një deputet konservator, Philip Davies, reagoi duke thënë se sistemi juridik në Brit-

ani ka probleme. Hektor Mahmutaj është dënuar me 25 vite burg për vrasjen e Gentjan Jahajt, në korrik të vitit 1997.

Arrestohet hajduti shqiptar për llogari të Belgjikës

Policia e Kurbinit ka vënë në pranga një 27-vjeçar, që ishte shpallur në kërkim nga drejtësia belge si pjesë e një grupi kriminal. Operacioni është zhvilluar nga Komisarjati i Policisë Kurbinit në bashkëpunim me Task Forcën "Anti Skifter" pranë Policisë së Shtetit. Policia deklaroi zyrtarisht se është arrestuar shtetasi E.K., 27 vjeç, banues në Kurbinit për llogari të drejtësisë belge, në kuadër të operacionit të përbashkët ndërkombëtar të koduar "Pikaso", për goditjen e një grupi kriminal në fushën e vjedhjeve të banesave dhe të pronave në Belgjikë. Si rezultat i këtij operacioni janë arrestuar 8 shtetas shqiptarë, 3 prej tyre në Shqipëri dhe 5 në Belgjikë. Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, me vendim të datës 25.04.2019 ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg", për veprat penale në ngarkim të tij "Vjedhje me shumë së njëherë", "Grup i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave kriminale nga grup i strukturuar kriminal" bën të ditur policia.



NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03.05.2019, ora 11:00.
- Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
- Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Afati i evadimit:** 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Vlera fillestare:**

Ne kushtet FOB:

Çmimi minimal fillestar per njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent + K

Në pikat e lëvrimit:

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent – 2.97 USD/bbl + K

- 75.27 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (pesha specifike, aciditeti i naftës, % e squfurit).
- Brent është çmimi në \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik.
- 2.97 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).

- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlogarit nga formula (Ke⁰).

- Vendndodhja e naftës brut: Albpetrol sha Patos:** Në pikat e levrimit Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrez, Stacioni Kuçovë, Stacioni Amonice.
- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 03.05.2019, ora 11:00.
- Data e hapjes së ofertave:** datë 03.05.2019, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

12. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po Jo X

- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.

Policia e Shtetit informon se ka arrestuar një 58-vjeçar në Tiranë, pasi kërkohej nga drejtësia italiane. Ai kërkohej nga Interpoli, për shkak të dyshimit se ishte pjesë e një organizate kriminale, që merrej me trafik kokainë nga Holanda në Itali. "Gjykata e Napolit në Itali ka vendosur ndaj këtij shtetasi masën e sigurisë 'Arrest me burg' për veprën penale 'Organizate kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike', parashikuar nga neni 74 i ligjit 309/1990 dhe Nenet 3, 4 të ligjit 146/2006 të Kodit Penal italian. Gjatë vitit 2016 dyshohet se ky shtetas ishte pjesë në një organizate kriminale, e cila

Pranga 58-vjeçarit në Tiranë, kishte vendim nga Gjykata Napolit



merrej me trafikimin e lëndëve narkotike të llojit kokainë dhe heroinë nga Holanda drejt Italisë. Vep- rimet e mëtejshme për ekstradimin e këtij shtetasi do të kryhen nga ZQK Interpol Tirana.

Kapen 50 kile hashash në Vlorë, dy bien në pranga

Policia e Vlorës ka goditur një tjetër tentativë në fushën e kultivimit dhe tregimit të lëndëve narkotike, duke sekuestruar 48 kilogramë kanabis në një banesë, si dhe 97 fidanë në kubikë. Në pranga kanë përfunduar dy shtetas. Operacioni është zhvilluar në lagjen "24 Maji" Vlorë, ku në një banesë janë gjetur dhe sekuestruar 48 kilo-



të tjera. Policia ka arrestuar në kushtet e flagrancës në këtë banesë shtetasit Z.I., 36 vjeç dhe E.B., 30 vjeç, të dyshuar si autorë përgjegjës në lidhje me këtë veprimtari të paligjshme. Materialet i referuan prokurorisë në ngarkim të këtyre shtetasve për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike" dhe "Kultivimi i bimëve narkotike", kryer në bashkëpunim.

Ka përfunduar gjyqi ndaj trafikantëve të drogës të llojit marijuanë nga Shqipëria në Itali. Gjyqi kundër 25 të pandehurve të përfshirë në trafikun e drogës, të cilët u arrestuan në kuadër të operacionit "Stammer 2-Melina", ka mbaruar me dhënien e 19 dënimeve. Hetuesit italianë kanë zbuluar se bandat e trafikut të lëndëve narkotike në Shqipëri bashkëpunonin me ato të Italisë. Dënimet më të larta janë dhënë për ata që cilësohen koka të grupeve kriminale, Gianfranco Contestabile dhe shqiptari Shefik Muho, 34 vjeç, shkruajnë mediat italiane. Përpos tyre, 18 vite burg janë dhënë për Indrit Bujën, 37 vjeç, tjetër shqiptar. Salvatore Pittitto, 52 vjeç, u dënua 12 vite burgim. Dënime me 11 vite burgim janë dhënë për Elvis Hajdinin dhe Giovanni Pastorello, përkatësisht 25 dhe 59 vjeç. Massimo Pannaci, 52 vjeç Vibo u dënua me 10 vite burg, plus me një gjobë prej 40 mijë euro, raporton "Gazzetta Del Sud". Ndërkohë, 9 të pandehur të tjerë janë dënuar me nga 4 vite burgim. Antonio Massimiliano Varone, 44 vjeç Mi-

Mes të dënuarve është edhe një femër, Indrit Buja merr 18 vite burg

Çonin hashash në Itali, gjykata vendos dënimet

Shefik Muho dhe Contestabile ishin kokat



leto u dënua me 4 vite heqje lirie dhe gjobë 24 mijë euro. Fortunato Baldo, 23 vjeç u dënua 4 vite dhe pagoi gjobë 20 mijë euro, ndërsa Francesco Colangelo pagoi 18 mijë euro gjobë etj. Të gjithë janë shtetas italianë. Së fundi, tre të pandehur të tjerë u dënuar me tri vite e katër muaj dhe me një gjobë prej 12,000 euro secill, të tre janë italianë. Të dënuar kanë përfunduar edhe italianë të tjerë të organizatës. Droja e kishte origjinën nga Shqipëria.

Përplasje me armë në Laç, vdesin kushërinjtë

Kanë ndërruar jetë në spital dy të plagosurit e mbrëmjes së djeshme. Ngjarja që tronditi qytetin e Laçit, ndodhi rreth orës 20:15 në lagjen nr. 1 afër një lokali, ku Mikel Jushi 35 vjeç, Jani Jushi 30 vjeç (kushërinj) fillimisht mbetën të plagosur. Edhe pse ata u transportuan në kryeqytet, nuk kanë mundur dot të shpëtojnë. Policia Kriminale ka nisur punën për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve. Nuk dihen ende shkaqet e kësaj ngjarje të rëndë. Disa shërbime të tjera policore kanë ngritur pika kontrolli dhe po vijon shoqërimi i personave që mund të kenë dijeni për rrethanat e ngjarjes

Patrulla e Përgjithshme e Komisarariatit të Policisë Fier gjatë patrullimit në orët e para të mëngjesit, në dalje të qytetit të Fierit ka konstatuar një automjet "Renault", që kryente lëvizje të dyshimta dhe pora ka parë makinën e policisë, është larguar me shpejtësi. Patrulla e Përgjithshme është vënë në ndjekje të automjetit si dhe ka kërkuar ndihmën e shërbimeve të tjera, ku menjëherë në ndihmë të tyre janë nisur forca të tjera policore të DVP Fier. Gjatë ndjekjes njëri prej pasagjerëve ka mundur të largohet duke përfutur nga errësira, ndërsa drejtuesi i mjetit dhe një pasagjer tjetër janë kapur në flagrancë. Gjatë kontrollit në automjet policia gjeti dhe

Të rinjve iu gjetën edhe doza kanabisi

Lëviznin të armatosur, policia e Fierit arreston dy durrsakët

sekuestroi një armë zjarri pistoletë me silenciator së bashku me karikator me fishekë, si dhe një dozë me lëndë narkotike kanabis sativa. Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasit: F.K., 22 vjeç, banues në Durrës, drejtuesi i mjetit, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike" dhe "Armëmbajtje pa leje". K.Gj., 22 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale "Moskallëzim krimi". Gjithashtu, u bë shpallja në kërkim e shtetasit A.P., 29 vjeç, banues në Durrës, me precedentë kriminalë të mëparshëm në fushën e krimeve ndaj pronës. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit A.P., policia e Fierit në bashkëpunim me policinë e Durrësit kanë gjetur 40 doza me lëndë narkotike kanabis sativa. Specialistët për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve të Paligjshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier po vijojnë punën për zbardhjen e plotë të rrethanave dhe qëllimit të lëvizjes së këtyre personave të armatosur nga Durrësi në Fier.

unicef for every child UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF) Albania Country office

CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST - EOI-ALBA-2019-002

The UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF), ALBANIA Country Office, would like to announce a Call for Expression of Interest addressed to Civil Society Organizations (CSOs) for a prospective partnership with UNICEF Albania Country Office in the implementation of the activity

"Improving the nutrition status of school age children in Albania".

For further details on the required partnership and on how to respond to the Call, please consult UNICEF Albania (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers>) and UN Albania (<http://www.un.org/al/employment-and-procurement>) websites.

Applications from interested CSOs must be delivered to UNICEF Tirana Office not later than **13 May 2019, at 16:30 hr.**

Applications must be submitted in a sealed envelope, clearly marked **"Call for Expression of Interest - EOI-ALBA-2019-002 - Improving the nutrition status of school age children in Albania"**, at the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rruga "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë,
Tiranë, Albania
Tel.: + 355 4 454 8400
Website: www.unicef.org/albania

SPASTRIMI ETNIK DESHMITE

Shqiptarët e Çamërisë në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme



Nga Prof.Dr.Selman Sheme*

Këtë vit mbushen 75 vjet nga akti final i gjenocidit grek dhe spastrimit etnik të krahinës së Çamërisë nga popullsia shqiptare myslimane. Në këtë shkrim do të trajtojmë rrethanat historike, metodat dhe etapat e shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve të Çamërisë nga trojet e veta stërgjyshore.

Migracionet zënë një vend të veçantë dhe me peshë në popullimin human të krahinës së Çamërisë dhe zhvillimin e saj në shekuj. Zhvillimet ekonomike dhe politiko-shoqërore, por sidomos faktorët shkatërrues të jetës shoqërore, si pushtimet koloniale, luftërat civile dhe spastrimet etnike me dhunë, shpronësimet dhe diskriminimi sociale etj., kanë diktuuar lëvizjet migruese të popullsisë shqiptare të Çamërisë në shekuj.

Shpërnguljet e dhunshme dhe me pasojë shkatërruese për strukturën demografike të krahinës së Çamërisë janë ato të 100 viteve të fundit. Gjurmët e dëbimit me forcë të popullsisë shqiptare nga trojet e tyre i ndeshim që në gjysmën e shek. XIX. Por ky proces bëhet më i dukshëm dhe në mënyrë të organizuar pas luftës ruso-turke të viteve (1877-1878) dhe Kongresit të Berlinit (1878). Synimet ishin të qarta: zgjerimi i kufijve shtetërorë tradicional të Greqisë dhe grabitja e tokës dhe e pasurive të paluajtshme të shqiptarëve.

Shpërngulja me forcë e në rrethanat të përdhunshme e popullsisë shqiptare të Çamërisë nga trojet e veta nuk u bë në të njëjtën kohë e në mënyrë të pandërprerë. Këto procese janë zhvilluar në momentet historike me kritike për fatet e popullit shqiptar, kryesisht në viset periferike të trugut etnik, siç është Çamëria.

Vala e parë e shpërnguljes u përket viteve '80 të shek. XIX, kur Greqia e ndihmuar nga Fuqitë e Mëdha, në bazë të vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit (1878) mori nga Turqia rrethet e Artës dhe shpërnguli me forcë popullsinë shqiptare nga këto troje.

Faktet tregojnë se në fillim të shek. XX shpërngulja e popullsisë shqiptare nga krahina e Çamërisë

masakrimi i cameve me sepata



The Genocide of the Greeks

bëhet më intensive e masive dhe është e orientuar geografikisht në mjediset qendrore të trojeve shqiptare, në Turqi, në SHBA etj.

Një fazë e re dhe me pasojë tragjike për popullsinë shqiptare të Çamërisë dhe të viseve të Konicës, Kosturit, Follorinës etj., fillon me luftërat Ballkanike dhe copëtimin e Shqipërisë nga vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Me këto vendime pjesa më e madhe e sipërfaqes dhe shumica e qyteteve dhe fshatrave të Çamërisë mbetën jashtë kufijve të shtetit të sapoformuar shqiptarë, duke rënë nën sundimin grek. Diplomati i shquar shqiptar, Rasih Dino, i deklaroi Konferencës së Londrës, se "paqja dhe qetësia e gadishullit do të arrihej vetëm në qoftë se Shqipërisë së ardhshme do t'i jepej një strukturë homogjene dhe kufijtë e saj të ndiqnin vijën e kufirit të atëhershëm me Malin e Zi, të përfshinin bashkë me hinterlandin e tyre përkatës, qytetet e Ipekut, Mitrovicën, Prishtinën, Shkupit e Manastirit, deri në Mecovë dhe të ruanin kufijtë ekzistues me Greqinë deri në Prevezë".

Për të nënshtruar përfundimisht viset shqiptare, administrata greke ndërmori aksionin e mbledhjes së armëve, vendosi gjendjen e shtettrëthimit dhe ndalimin e qarkullimit të Shqiptarëve jashtë juridiksionit të fshatit apo

qytetit të tyre. Autoritetet ushtarake e administrate civile, filluan të shpronësojnë popullsinë myslimane shqiptare dhe të ushtrorë dhunë mbi ta për t'i detyruar të shpërngulshin.

Ndërsa, popullsinë e krishterë e shtërësonin të mohonte përkatësinë kombëtare dhe të pranonte etnitetin helen e të shpallej greke. Për të shtypur qëndresën e shqiptarëve u ndërmorën masa të egra terrori dhe u shkatërruan qindra shtëpi në fshatrat e Çamërisë. Në vitin 1913-1914 në Kazanë e Paramithisë u shkatërruan fshatrat Gardhiq me 300 shtëpi, Dhragomia me 200, Petrovica me 75, Minina me 65 shtëpi. Në Kazanë e Filatit u shkatërruan ndër të tjerë: Ninati me 120 shtëpi, Markati me 12, Janjari me 150 shtëpi, e tjerë.

"Fati i Shqiptarëve të provincës së Çamërisë, - shkruan F.S.Noli, - provincë e aneksuar prej Greqisë nuk ndryshon nga ai i kosovarëve. S'është veçse një ribotim i tragjedisë në tri akte: ç'pasurim, ç'përngulje, ç'farosje".

SPASTRIMI ETNIK GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Në rrethanat e luftërave ballkanike dhe të pushtimit të Çamërisë fillon etapa e parë masive e shpërnguljes së dhunshme të popullsisë së krahinës për në Turqi, Shqipëri e vende të tjera të Ballkanit, në SHBA e tjerë. Për pasojë, vetëm gjatë

Luftës së Parë Botërore u dëbuan nga trojet e tyre stërgjyshore rreth 10.000 shqiptarë të Çamërisë, të cilët u dërguan në Turqi. Gjatë shpërnguljes pati shumë të vrarë e të masakruar.

Në vitet 1913-1914, duke kaluar kufijtë e porsacaktuar të Shqipërisë, ushtria greke vrau, dogji e shkatërroi mjaft vendbanime rurale e urbane në rrethet e Korçës, Kolonjës, Përmetit, Skraparit e Tepelenës, duke përfshirë edhe Kurveleshin. U shkatërruan 190 fshatra dhe dy qytete. Popullsia që u detyrua të largohej prej andej, erdhi e u vendos në ullishtat e Vlorës, ku nga vuajtjet, sëmundjet dhe uria vdiq një numër i madh refugjatësh. Mis. E. Durham, që shkoi t'u jepte ndihmë mjekësore e ushqime, thotë se brenda dhe jashtë Vlorës bëheshin së bashku së paku nja 70.000 frymë, përveç atyre që kishin zënë vend në mes të Beratit e Vlorës dhe në tokat malore.

Midis këtyre mijëra refugjatëve nga Shqipëria e Jugut, që qenë të detyruar nga dhuna e bandave "vorio-epirote" të vendoseshin në ullishtat e Vlorës kishte edhe rreth 20.000 shqiptarë janinas, vashtinjarë, konicarë, e tjerë.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, shqiptarët e Çamërisë dhe të krahinave të tjera shqiptare në Greqi, mbështetën programin e Lëvizjes Kombëtare për të krijuar një Shqipëri në kufijtë e saj etnikë. Me përfundimin e luftës dhe me thirrjen e Konferencës së Paqes në Versaj (Paris), lëvizja për bashkimin e Çamërisë me shtetin shqiptar u zgjerua. U krijuan shoqëritë e para të mirëfillta came, në Shqipëri, SHBA e tjerë, në të cilat u aktivizuan shqiptarë nga Çamëria dhe emigrantë nga trojet e tjera Shqiptare.

Me gjithë shpresat që ushqenin shqiptarët të Konferenca e Paqes e Varsajes, kjo konferencë nuk solli asnjë ndryshim në gjendjen e popullsisë shqiptare, që kishte mbetur nën qeverisjen greke. Këqtrajtimi i popullsisë së pafajshme do të vijojë në vitet 1919-1921, e më pas në Shqipërinë Jugore e Juglindore, në të dyja anët e kufirit. Viset kufitare greko-shqiptare qenë objekt i një dhune të egër, prandaj dhe largimet e popullsisë qenë më të shumta: Si rrjedhim, numri i popullit shqiptar në krahinë erdhi vazhdimisht duke rënë.

Në vitin 1921, në Memorand-

diumin e Përfaqësuesve të Komitetëve të Bashkuara të shqiptarëve irridente, drejtorit Bonin Longarit, ambasadori i Italisë dhe anëtarit i Konferencës së Paqes, vërtetuar nga Prof. Bedri Pejani, ndër të tjera kërkohet që t'i kthehen Shqipërisë Çamëria dhe trojet e tjera Jug-Shqiptare të aneksuara nga Greqia.

SPASTRIMI ETNIK PAS TRAKTATIT TË LOZANËS (1923-1926)

Në verën e vitit 1922, pas disfatës greke në luftë me Turqinë, dështoi projekti grek i Megali-Ides për aneksimin e Azisë së Vogël dhe sundimin e Greqisë në ish-territoret e Perandorisë Bizantine. Për rrjedhojë, në vitet 1921-1922 filloi një periudhë e re tensioni politik në Greqi, që u shoqërua me aksione agresive ushtarake kundër shqiptarëve etnikë.

Nën monitorimin e Fuqive të Mëdha e të Lidhjes së Kombeve, më 30 janar 1923 u nënshkrua Traktati i Lozanës midis Turqisë dhe Greqisë. Në një nga nenet e tij përcaktohej shkëmbimi i popullsisë turke në Greqi me atë greke në Turqi. U vendos që të ngrihej një komision i Lidhjes së Kombeve për të ndjekur zbatimin e dispozitave të shkëmbimit, së bashku me disa nënkomisione.

Komisioni Mikst, i ngarkuar nga Lidhja e Kombeve për zbatimin e shkëmbimit vendosi të "përfshijtohej popullsia shqiptare e besimit mysliman të Çamërisë". Këtë fakt e kishin pranuar edhe qeveritarët e Athinës. Përfaqësuesi grek në Lidhjen Kombëtare, Kaklamanos deklaroi se, "qeveria greke nuk ka për qëllim të shkëmbijë myslimanët me origjinë shqiptare, se shqiptarët banojnë në një krahinë të përcaktuar mirë, në Epir. Në qoftë se ata janë të një besimi me Turqit, nuk janë kurrsesi të një kombësie".

Autoritetet greke në kundërshtim me deklaratat e tyre, duke shfrytëzuar rrethanat e krijuara ndërmorën masa të gjithanshme për pastrimin etnik të popullsisë shqiptare duke i etiketuar si turq.

Masat qeveritare ndaj shqiptarëve myslimanë që padrejtësisht u nënshtruan "andallaisë" (shkëmbimimi) u zbatua me egërsi të madhe. Çeta audartesh dhe kriminelësh profesionistë grekë masakruan popullsinë, e grabitën dhe e shpronësuan për ta detyruar



të largohej në Turqi.

Me "andalliaan" (shkëmbimin) filloi etapa e dytë e spastrimit etnik që iu bë popullit çam.

Në takime me Komisionin e Lidhjes së Kombeve, përfaqësuesit e Çamërisë mbrojnë me vendosmëri identitetin e tyre shqiptar. Ata deklarojnë në mënyrë kategorike se janë shqiptarë dhe nuk i lidh asgjë me Turqinë, duke shprehur me këmbëngulje e vendosmëri kundër shkëmbimit dhe dhunës.

Në vitet 1920-1926, gjatë shpërnguljeve me dhunë u dërguan me forcë në Turqi 35.000 shqiptarë, banorë të 24 fshatrave të Kosturit dhe të 14 fshatrave të Follorinës, si dhe 55.000 shqiptarë myslimanë të Epirit (Çamërisë), pjesa më e madhe nga rrethet e Janinës, Prevezës dhe të Pargës. Këto qytete, që deri në atë kohë kishin mbajtur të gjallë frymën kombëtare, me largimin (shpërnguljen) e popullsisë shqiptare myslimanë për në Anadoll, filluan të asimilohen.

Në shtëpitë e shqiptarëve myslimanë u vendosën dhunë refugjatët grekë të Azisë së Vogël, ndërsa shtëpitë e banuara nga të krishterët dhe grekët nuk u prekën. Padrejtesia ishte e hapur, mizore dhe çnjerëzore.

Në vitet 1922-1927 rreth 1400 shqiptarë të Çamërisë emigruan në Shqipëri. Emigracioni në Shqipëri vijoi në mënyrë periodike gjatë gjithë gjysmës së parë të shek. XX. Që nga fillimi i vënies në jetë të Traktatit të Lozanës e deri në vitin 1937 kanë migruar në Shqipëri e në Amerikë 27.000 shqiptarë myslimanë.

Me ardhjen në pushtet të qeverisë fashiste të Joanis Metaksait më 1936, gjendja e popullit shqiptar në Çamëri u bë edhe më e vështirë. Kolonizimi i rajonit nga grekët u intensifikua. Shpronësimi i popullit çam nga pasuria e tyre u vazhdu dhe emrat e vendeve (toponimet) të banuara nga shqiptarët u zëvendësuan me emra grekë.

Sipas statistikave greke të vitit 1937, Çamëria kishte 279 fshatra me një popullsi prej 112.619 banorë, nga të cilët vetëm 20.200 banorë ishin grekofonë dhe 92.419 ishin shqiptarë.

FINALIZIMI I SPASTRIMIT ETNIK NËPËRMJET GJENOCIDIT (1939-1945)

Procesi i shpërnguljes së popullsisë çame nga trojet e veta dhe helenizimit të saj u fut në një fazë të re gjatë luftës italo-greke (1940-

1941) dhe arriti pikën më kulmore me ngjarjet tragjike të viteve 1944-1945.

Në prag të shpërthimit të luftës italo-greke, represioni i qeverisë greke ndaj popullit shqiptar të Çamërisë u rrit ndjeshëm. Qeveria armatosi banda paramilitantësh ushtarakë, të cilët filluan të terrorizojnë shqiptarët në të dyja anët e kufirit. Rekrutët çamë në ushtrinë greke megjithëse shfaqen dëshirën për të luftuar kundër italianëve u trajtuan jo si ushtarë, por si robër lufte. Në vend të pushkëve, atyre ju dhanë kazma e lopata për të punuar e vepruar në prapavijë për ndërtime rrugësh. Në këtë mënyrë, qeveria fashiste e Metaksait tregoi zyrtarisht mungesë besimi ndaj tyre, duke i poshtëruar e trajtuar jo si qytetarë grekë, por si të huaj të dyshimtë. Ky qëndrim përbuzës u përshirit edhe në mobilizimin e përgjithshëm. Tensioni politik në Çamëri u rrit në pikën kritike kur autoritetet greke, të ndërgjegjësuar për shtypjen e ushtruar kundër popullit shqiptar në Çamëri dhe të frikësuar nga ndonjë kundërveprim, urdhëruan internimin me dhunë të gjithë meshkujve mbi moshën 16 vjeç, të cilët i futën nëpër burgje të ndryshme në ishujt e Detit Egje (Chios, Medelin, Korynth, Lefkada e tjerë). Numri i të burgosurve është llogaritur në mbi 5000 veta, prej të cilëve 550 u vranë ose vdiqën në tortura.

Në këtë situatë, Italia intensifikoi propagandën antigreke duke premtuar edhe çlirimin e minoritetit shqiptar në Greqi. Popullsia

çame mbajti një qëndrim neutral ndaj palëve në konflikt. "Edhe kur italianët pushtuan Gumenicën - shkruan Jani Sharra - rrallë ndonjë çam u bashkua me ta".

Një grup antifashistësh çamë i kryesuar nga Musa Demi iu kundërvu propagandës italiane para shpërthimit të luftës, por veprimtaria e tyre u ndërpre nga autoritetet greke. Gjatë muajve korrik-gusht 1940 krerët e Çamërisë u internuan. Pas thyerjes së ushtrisë italiane dhe tërheqjes së tyre nga Greqia, qeveria greke ndërmori një valë të re dhune e terrori mbi popullsinë shqiptare të Çamërisë.

Të burgosurit dhe të internuarit u liruan vetëm pas pushtimit të Greqisë nga ushtritë gjermane, në një gjendje shëndetësore e shpirtërore të rëndë. - Pas pushtimit të Greqisë nga gjermanët, qarqet shoviniste greke nxitën krijimin e bandave kriminale për të vrarë pjesëtarët e parisë së Çamërisë. Popullsia çame u ngriti mbi pasionet dhe urrejtjen nacionale dhe zgjodhi rrugën e bashkëjetesës e të bashkëpunimit me popullsinë e krishterë, për të përballuar bashkërisht gjendjen e rëndë që u krijua pas pushtimit gjerman. Për këtë qëllim, njerëz me ndikim në krahinë u përqopën të krijonin atmosferën e mirëkuptimit midis dy komuniteteve, grekë e shqiptarë.

- Popullsia çame në përgjithësi nuk pranoi mobilizimin ushtarak dhe bashkëpunimin me gjermanët në luftë kundër popullit grek. Nacionalistët bënë përpjekje për t'u

lidhur me Shtabin Aleat të Mesdheut, me qëllim që të mënjanonin rrezikun zervist që i kanosej Çamërisë.

- Popullsia çame ka dhënë një kontribut të njohur në luftën antifashiste nacionalçlirimtare. Rezistenca antifashiste e kësaj popullsie fillon në dimrin e viteve 1942-1943. Në shkurt të vitit 1943 u krijua çeta "Çamëria" dhe pak më vonë batalioni "Çamëria", i cili zhvilloi në shtator 1943 betejën e famshme të Konispolit, kundër gjermanëve, që zgjati 55 ditë. Në këtë periudhë të trazuar, kur Napoleon Zerva dhe bashkëpunëtorët e tij kërkonin të shuanin rezistencën antifashiste në Çamëri dhe luftën e popullit çam kundër fashizmit, në maj 1944 u formua batalioni i minoritetit çam, që mban emrin e heroit të LANÇ-it, birit të Filatit "Ali Demi". Brenda disa muajve numri i partizanëve të batalionit "Ali Demi" u rrit 500 e ca luftëtarë. Ky batalion ishte inkuadruar në divizionin XV të ELLAS-it.

- Në verën e vitit 1944 tensionet politike në Çamëri u rritën dhe pasiguria e popullsisë çame u shtua.

- Më 27 qershor ndodhi masakra e përbindshme e forcave të Napoleon Zervës kundër popullsisë shqiptare të Paramithisë, që është masakra më e egër ndaj shqiptarëve myslimanë. Në atë ditë forcat e Ligës Republikane Greke (EDES) të gjeneralit Zerva hyjnë në qytet dhe vranë rreth 600 shqiptarë myslimanë, burra, gra dhe fëmijë. Shumë prej tyre u përdhunuan dhe u torturuan para vdekjes. Të nesërmen një batalion tjetër i EDES-it hyri në Pargë, ku vrau 52 shqiptarë të tjerë. Masakrat vazhduan 3-4 ditë, jo vetëm në qytete, por edhe nëpër fshatra. Me këto ngjarje fillon ekodi çam, që ndodhi në vitet 1944-1945. Në vjeshtën e vitit 1944 situata politike në Çamëri ishte jashtëzakonisht kritike. Në këtë periudhë forcat zerviste iu afruan qytetit të Filatit në një kohë që forcat gjermane ende nuk ishin larguar. Në mëngjesin e 24 shtatorit Filatit ra në duart e zervistëve, të cilët përsëritën krime të ngjashme me ato që kishin ndodhur në Paramithi. Përveç poshtërimeve, shkatërrimeve, grabitjeve dhe çnderimeve të grave, vetëm në dy ditët e para u therën dhe u vranë 259 banorë të Filatit dhe 157 banorë të fshatit Spatar.

- Raprezaljet e Paramithisë, Pargës, Karbunarit, Spatarit, Filatit etj., ku u masakruan edhe fëmijët, nuk la më asnjë lloj iluzion. Shumica e njerëzve u bindën për fatin që i priste. Filloi kështu ekodi bibli i popullsisë çame, i cili

të kujton eksodin bibli i izraelitëve, ndodhur 3300 vjet më parë. Duke u larguar, ata lanë pas shtëpi të djegur, kufomat e të afërmeve të pavarrosur dhe të pushtuar nga tmerr. Largimin e tyre, historiani Jani Sharra e përshkruan me këto fjalë.

"Mijëra njerëz, burra gra e fëmijë, me dhimbje dhe keqardhje në fytyrat e tyre, niseshin me ç'mundnin të merrnin me vete, në rrugën e shpëtimit".

Në dhjetor të vitit 1944 kaluan kufirin shqiptar kolonat e fundit të refugjatëve shqiptarë çamë, të përbërë nga gratë dhe fëmijët që kishin mbetur në burgjet e Paramithisë, Filatit, Janinës etj.

- Pas largimit të banorëve autoktonë, situata në Çamëri u rëndua edhe më shumë si rezultat i ashpërsimit të konfliktit që çuan në luftime të ashpra midis forcave të ELLAS-it, (të majta) e të EDES-it (të djathta) të N.Zervas.

Në dhjetor të vitit 1944 Fronti Nacionalçlirimtar i EAM-it dhe forcat e ushtrisë NÇG (ELLAS), çliruan Çamërinë dhe në fillim të janarit 1945 i detyruan forcat zerviste (EDES) të kalonin në Korfuz. Në luftimet për çlirimin e Çamërisë një ndihmesë të rëndësishme dhanë edhe djemtë çamë të inkuadruar në batalionin "Ali Demi" dhe në formacione të tjera. Në këtë situatë të re, një pjesë e popullsisë çame (3000-5000 veta) u rikthyen në shtëpitë e tyre duke pësuar masakrën e dytë akoma më të pabesë. Refugjatët çamë kishin marrë sigurinë verbale edhe nga Misioni Britanik në Tiranë.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së Varkizës (13 shkurt 1945) EAM-i pranonte që ELLAS-it të dorëzonte armët. Pas dorëzimit të armëve, luftëtarët çamë të batalionit të IV "Ali Demi" u nisën për Shqipëri të çarmatosur. Shumë prej tyre u vranë gjatë rrugës nga forcat qeveritare të gjeneral Plastiras. Në mënyrë të pabesë garnizoni edeist në Korfuz shkeli marrëveshjen duke kryer sulmin final kundër Çamërisë. Bandat edeiste pasi ripushtuan Çamërinë, iu drejtuan Filatit, duke realizuar një gjakderdhje të tmerrshme. Kjo që fushata e fundit e masakrës së zervistëve kundër popullsisë shqiptare të Çamërisë.

Spastrimi etnik i Çamërisë krijoi precedentin e rrezikshëm të spastrimeve etnike në Ballkan. Ai ndryshoi dukshëm balancën etnike në raportet greko-shqiptare, në favor të grekëve dhe krijoi një problem, që do të ndikonte për një kohë të gjatë në ndërgjegjen e popullit shqiptar. Spastrimi etnik i Çamërisë nxitte dhe fuqizoi presionet e shtetit grek ndaj kombit dhe shtetit shqiptar, duke avancuar planet dhe aktivitetet për aneksimin e Shqipërisë së Jugut.

Bazuar në Konventën europiane dhe Deklaratën Universale, shteti grek duhet të kryejë detyrimet ligjore kushtetues për trajtimin e popullsisë çame dhe arvanitase në Greqi si pakicë etnike. Njëkohësisht riatdhësimi i popullsisë çame që banon në shtetin amë, në trojet e veta në Çamëri dhe kthimi i pronave të tyre do të përmirësonte situatën demografike dhe ekonomike të kësaj krahine. Vetëm në këtë mënyrë mund të metohet për integrim dhe demokratizim të rajonit të Ballkanit.

*Pedagog në Departamentin e Gjeografisë në Universitetin e Tiranës



Pashkët zbukurojnë qytetin, turistët festojnë me birrën "Korça"

Pashkët e kthyen Korçën këtë fundjavë në qendrën e turizmit shqiptar, atje ku u mbledhën shumë turistë të ardhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Por, për të gjithë ata që vizitojnë Korçën, është e pakuptimtë të shijosh dreqën pa shijen e birrës "Korça". Kjo si duket bëri që ashtu si gjithnjë, por kryesisht në ditë festash dhe fundjava, restoranti i njohur si "Shtëpia e birrës Korça" edhe në këtë të diel Pashkësh të mikpriste qindra turistë. Ushqime tradicionale që shoqërohen me shijen e birrës së parë shqiptare që gjithnjë krijon atmosferë të veçantë për klientët. Festat janë gjithnjë çaste të veçanta gëzimesh, por ata mbeten në kujtesë kur zgjedh Korçën dhe "Shtëpinë e birrës" me emrin e saj, teksa ndjen ndërthurjen harmonike të shijes së birrës, ushqimeve të veçanta dhe natyrën që ofron Korça.



Diellza Kolgeci sjell në jetë fëmijën, ja emri i bukur i vogëlushes

Diellza Kolgeci dhe Fisnik Rugova janë bërë prindër për herë të parë. Bukuroshja kosovare ka sjellë në jetë një vajzë, të cilës i kanë vënë emrin Helena. Lajmi për shtatzëninë e Diellzës dhe për lidhjen e saj me basketbollistin Rugova është marrë vesh kur Diellza ishte në muajt e fundit të shtatzënisë. Mësohet se Diellza dhe e vogla gëzojnë shëndet të plotë, ndërsa Helena Rugovës i urojmë një jetë të gjatë e të lumtur me prindërit.



Vidhen dhe sulmohen në Greqi! Këngëtarët shqiptarë tregojnë peripecitë

Këngëtarë i njohur, Alban Ramosaj dhe Beatrix Ramosaj ditën e shtunë janë nisur së bashku në një udhëtim në Greqi. Ata kanë shpërndarë gjatë gjithë kohës momente nga udhëtimi, mirëpo kur kanë arritur në Selanik, një gjë e papritur u ka ndodhur. Në disa postime në "Instastory", Albani dhe Beatrixi kanë zbuluar se disa persona kanë thyer xhamin e makinës së tyre dhe kanë marrë të gjitha gjërat me vlerë, pasaportat dhe dokumentet e tyre. "Hera e parë në Greqi dhe na thyen makinën dhe vodhën pasaportat tona, dokumentet e makinës dhe disa gjëra të tjera. Kemi lajmëruar policinë dhe askush nuk është shfaqur ende. Çfarë duhet të bëjmë? Është çmenduri", ka shkruar Beatrixi, ndërsa po ashtu edhe Albani ka reaguar. "OK, para se të gjykoni që si mund të hedh një gjë të tillë në 'Instagram', është hera e parë që ndodh diçka e tillë. Na vodhën pasaportat e disa dokumente të tjera. Nuk kemi njeri në këtë qytet dhe policia ka mbi një orë e gjysmë që 'është rrugës'. Thua të jetë ngaqë jemi shqiptarë? Thua ta keni bërë se kanë parë targat shqiptare? Apo e bëjnë shpesh këtë gjë këtu? Ç'mikpritje!", ka përfunduar Albani.





YLLI MERJA:



Rënia e flokëve,
si ta kuroni me bimë
mjekësore

KESHILLA



ISHP: Kategoritë
më të riskuara për
t'u prekur nga
kanceri i gjirit

ALTIN ÇEKODHIMA:



Mjeku gastroenterolog:
Ja cilat janë simptomat
dhe shkaqet kryesore të
sëmundjes



Dieta që duhet të ndiqni për të shpëtuar nga hemorroidet

"Pini sa më shumë lëngje
dhe konsumoni ushqime me fibra"

Efektet e mrekullueshme të fikut në organizëm

Voltiza Duro

Hemorroidet prekin një pjesë të kon siderueshme të popullsisë e veçanërisht pas moshës 50 vjeç. Ato janë një prej sëmundjeve të anusit dhe rektumit e shkaktojnë kruajtje e djegie përreth zonës së prekur. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku gastroenterolog dhe endoskopist, Altin Çekodhima tregon simptomat kryesore të sëmundjes si dhe mënyrat e diagnostikimit. Ai shton se hemorroidet mund të jenë të shpeshta edhe te gratë shtatzëna, çka shpjegohet me presionin që fetusit shkakton në bark. Çekodhima shton se parandalimi i përsëritjeve të hemorroidëve mund të arrihet me një dietë të pasur me fibra dhe lëngje.

Doktor, mund të na tregoni se çfarë janë hemorroidet dhe cilët janë faktorët që ndikojnë në shfaqjen e tyre?

Termi hemorroidë i referohet një situatë në të cilën venat përreth anusit ose të pjesës së poshtme të rektumit janë të fryra dhe të skuqura. Hemorroidet mund të jene shkak i shtërzimeve për të defekuar. Faktorë të tjerë që luajnë rol në formimin e tyre janë: shtatzënia, plakja, konstipacioni (kapsllëku) kronik ose diarreja (barkqitja) kronike. Hemorroidet janë ose brenda anusit (interne) ose jashtë lëkurës përreth anusit.

Cilat janë simptomat kryesore të hemorroidëve që nuk duhet t'i neglizhohet?

Disa probleme anorectale që përfshijnë fisurat, abcesi, iritimi, kruajtja dhe djegia (pruritisi ani) kanë të njëjtat shenja dhe gabimisht u referohen hemorroidëve. Hemorroidet zakonisht nuk janë të rrezikshme ose rrezikojnë jetën. Në shumë raste simptomat e hemorroidëve ikin brenda disa ditëve.

A shoqërohen me gjakderdhje hemorroidet?

Ndonëse shumë njerëz që kanë hemorroidë nuk shfaqin shenja fare, shenja më e shpeshtë e hemorroidëve të brendshme është gjaku i pastër që lyen feçet, letrën e tualetit dhe WC e tualetit. Ndonjëherë hemorroidet e brendshme rrethojnë jashtë anusit irritohehen dhe bëhen të dhimbshme. Këto lloj hemorroidë quhen të prolabuara. Shenjat e hemorroidëve të jashtme përfshijnë dhimbje, enjtje, ose një kokërr e madhe përreth anusit si rezultat i mpiksjes së gjakut, situatë e cila njihet si trombozë e hemorroidëve të jashtme. Përveç kësaj, lodhja e tepruar, fërkimi ose pastrimi përreth

Disa probleme anorectale që përfshijnë fisurat, abcesi, iritimi, kruajtja dhe djegia (pruritisi ani) kanë të njëjtat shenja dhe gabimisht u referohen hemorroidëve. Hemorroidet zakonisht nuk janë të rrezikshme ose rrezikojnë jetën. Në shumë raste simptomat e hemorroidëve ikin brenda disa ditëve.



Mjeku gastroenterolog: Ja cilat janë simptomat dhe shkaqet kryesore të sëmundjes

ALTIN ÇEKODHIMA: Dieta që duhet të ndiqni për të shpëtuar nga hemorroidet

"Pini sa më shumë lëngje dhe konsumoni ushqime me fibra"



Mjeku gastroenterolog dhe endoskopist, Altin Çekodhima

zonës së anusit mund të shkaktojnë iritim të shoqëruar me hemorragji apo kruajtje, e cila mund të bëhet një rreth vicioz shenjash. Mukus i tepërt gjithashtu mund të shkaktojë kruajtje. **Cila është moshja dhe kategoritë më të predispozuar për t'u prekur nga kjo gjendje?** Hemorroidet janë shumë të shpeshta si te burrat, edhe te gratë. Rreth gjysma e popullsisë kanë hemorroidë rreth moshës 50 vjeç.

Gjithashtu, hemorroidet mund të jenë të shpeshta dhe te gratë shtatzëna, situatë e cila shpjegohet me presionin që fetusit shkakton në bark gjithashtu edhe ndryshimet hormonale shkaktojnë zgjerim të venave hemorroidale. Gjithsesi, hemorroidet gjatë shtatzënisë janë probleme kalimtare. Si diagnostikohen hemorroidet? Një diagnostikim i saktë mund të bëhet vetëm nga mjeku. Është shumë e rëndësishme që ju të para-

qiteni te mjeku specialist në momentin që keni hemorragji, sepse ajo mund të jetë shenjë e sëmundjeve të tjera të traktit tretës, përfshi edhe kancerin (kolorektal) i zorrës së trashë. Doktorit do të ekzaminonjë anusin tuaj nëpërmjet "touché rectale", ekzaminim digjital, që realizohet me gisht të lubrifikuar për të prekur anomalitë përreth. Një tjetër ekzaminim për hemorroidet është ai me anoskop, një tub i ndriçuar që lejon pamjen e anusit nga brenda për të vlerësuar hemorroidet e brendshme. Për të përjashtuar mundësinë e ndonjë sëmundjeje tjetër të traktit tretës është shumë e rëndësishme të kryhet videoekolonoskopia.


Si mund të bëhet parandalimi i formimit të hemorroidëve?

Trajtimi medikamentoz i hemorroidëve ka për qëllim të lehtësojë simptomat, por të rëndësishme janë masat parandaluese për formimin e tyre. Parandalimi i përsëritjeve të hemorroidëve do të kërkojë jashtëqitjen normale (pa

kapsllëk), e cila arrihet me një dietë të pasur me fibra dhe lëngje. Me anë të kësaj diete arrihet që materialet fekale të jenë të buta dhe lehtësisht të lëvizshme nëpër zorrë, duke mënjnuar shtërzimet në defektin dhe uljen e presionit të venave të anusit.

Çfarë ushqimesh rekomandoni ju për të minimizuar rrezikun e prekjes nga hemorroidet?

Duke ngrënë sasinë e duhur me fibra ushqimore dhe pirja e 6 deri në 8 gota lëngjesh (pa alkool) rezultojnë në jashtëqitje të butë e të formuar, e cila bën të lehtë zbrazen e zorrës. Fibrat ushqimore merren nëpërmjet konsumit të frutave, perimeve dhe miellit me përmbajtje krundesh. Mjeku mund t'ju rekomandojë të merrni edhe fibra suplementare, produkte farmaceutike. Aktiviteti fizik ku përfshihet edhe e cura, rritja e sasive të fibrave dhe lëngjeve në dietë janë një kombinim i duhur për parandalimin dhe mospërsëritjen e hemorroidëve.



Voltiza Duro

Alopecia Areata (AA) është një gjendje e cila shkakton rënie të flokëve, zakonisht me sipërfaqen e një monedhe. Kjo sëmundje mund të shkaktojë stres psikologjik. Alopecia Areata nuk është ngjitëse. Ajo Ndoth më shpesh në njerëz që kanë prekur anëtarët e familjes, duke sugjeruar trashëgim mund të jetë një faktor. Dëshmi e fortë e shoqatës gjenetik me AA rrezik në rritje u gjet për familjet me dy ose më shumë anëtarë të prekur duke studiuar. Kusht është menduar të jetë një çrregullim sistematik autoimun, në të cilin trupi sulmon folikulat flokët dhe suppresses ose ndalon rritjen e flokëve Anagen. Për shembull, limfocitet T celularë grumbull folikulash prekura përreth, duke shkaktuar inflamacion dhe humbjen e flokëve të mëvonshëm. Në disa raste kjo është raportuar edhe të foshnjat, por këto nuk janë raste të sëmundjes autoimune, për shkak se një i mitur është i lindur pa një sistem të zhvilluar patjetër imunitar.

FORMAT E SËMUNDJES:

Thuajse gjithmonë Alopecia është një gjendje transitorë e rikthyeshme dhe mund të dallohen disa forma të ndryshme të saj.

-Alopecia androgjenike jockikatricale konsiderohet si patologji e trashëgueshme dhe ka një kurs kronik. Ajo është shumë e zakonshme te burrat, por është vërejtur edhe te femrat. Humbja e flokëve fillon në zonat frontale-parietale dhe në majën e kokës e pastaj përhapet në të gjitha zonat.

-Alopecia cikatriciale konsiston në humbjen e flokëve si rezultat i traumave, inflamacionit apo infeksionit të indeve. Mund të shoqërohet me "planus lichen", "lupus eritematoz", djegie, ulçera, granuloma, sifiliz apo të tjera.

-Alopecia Areata është humbja e papiritur e flokëve. Ajo mund të jetë e lokalizuar ose e plotë. Karakterizohet më shpesh nga formimi i njollave pa flokë, të buta, të rrumbullakosura dhe të madhësive ndryshme. Format më të përhapura shfaqen para adoleshencës, më të lehtë mund të zhduken në mënyrë spontane në pak javë, por në raste të tjera alopecia vazhdon në periudha më të gjata.

-Alopecia toksike mund të shkaktohet nga marrja e kimioterapisë, nga doza të larta të retinoidit, nga miksedema, shtatzënia dhe periudha pas lindjes.

SHKAKTARËT KRYESORË

Shkaktari kryesor është stresi, por një ndikim jo të vogël kanë edhe lloji i shampos, apo kimi-



Mjeku popullore: Cilat janë format kryesore të Alopecia Areata, shkaktarët e sëmundjes

YLLI MERJA: Rënia e flokëve, si ta kuroni me bimë mjekësore

"Kujdes me përdorimin e xhelit e ushqimet e pashëndetshme"



Ylli Merja

kate të ndryshme që përdoren, xheli i flokëve, ushqime të pashëndetshme etj. Alopecia është sëmundje autoimunitare, ku trupi lufton vetveten. Në këtë rast trupi ndalon rritjen e flokëve, duke shkatërruar rrënjën e flokut. Alopecia mund të jetë pasojë e shkaqeve gjenetike ose të fituara. Në Alopecia Areata një nga arsyet më të besueshme janë ndryshimet në sistemin imunitar. Gjendja e skalpit të kokës dhe e flokëve pasqyron gjendjen shëndetësore të organizmit, kështu që nuk është e lehtë të identifikohet një arsye e vetme



që e shkakton. Në origjinën e formave të rikthyeshme mund të jenë faktorë të tillë si sëmundjet sistematike, episodet e stresit emocional, mungesat hormonale apo vitaminoze, barnat, shtatzënia, mosha e vjetër.

DIAGNOSTIKIMI I SËMUNDJES

Me një vizitë dermatologjike është e mundur të dallohen format infektive nga ato kronike. Është e këshillueshme që të vazhdohet me një dermoskopi të skalpit të kokës në kërkim të anomalive të mundshme apo lezimeve të lëkurës. Ekzaminimi shërben për të dalluar flokët në fazën e rritjes (anagen) nga ato që janë në fazë pushimi (telogen). Në alopecitë që rezultojnë nga

sëmundje sistematike ose të paslindjes rritet përqindja e fijeve të flokut në fazën telogen. Me anë të analizave të gjakut mund të diagnostikohet prania e njëkohshme edhe e një sëmundje autoimune. Humbja e flokëve, qoftë edhe e përkohshme, ka një ndikim shumë negativ në cilësinë e jetës dhe në vetëvlerësim. Alopecia, pavarësisht nga të pasurit e një dekursi benign, mund të shkaktojë ndjenjën e zemërimit, refuzimit, turp, ankthit dhe depresionit, sidomos te gratë.

TRAJTIMI ME BIMË MEDICINALE

Përzjerja bimore kundër rënies së flokëve dhe maska e flokëve janë shumë efektive kundër alopecisë dhe arrijnë të nxitin daljen e flokëve të reja për rreth 1 muaj deri në 1.5 muaj. Kura përdoret deri në 3 muaj. Vendoset maska e mbahet 5-6 orë, më pas me çajin lahet floku dhe pastaj përdoret ekstrakti i flokut për të lëvizur rrënjët e flokut. Ky trajtim mund të përdoret nga femrat dhe meshkujt.



Kanceri i gjirit është një tumor që zhvillohet nga qelizat e vetë gjirit. Kjo sëmundje është rritja jashtë kontrollit dhe përhapja e qelizave jo normale të indit të gjirit. Këto qeliza grumbullohen, formojnë një tumor i cili shtyp, përhapet dhe shkatërron indin normal të gjirit. Instituti i Shëndetit Publik më poshtë sjell një informacion të detajuar mbi këtë sëmundje e mënyrat e trajtimit të saj. Pa mjekim këto qeliza përhapen në pjesët fqinje e më pas në të gjithë trupin. Askush nuk e di shkakun e vërtetë të kancerit të gjirit, por dimë se disa njerëz janë më të rrezikuar për të zhvilluar kancer gjiri. Dimë se disafaktorë duken serri-sin rrezikun për të zhvilluar kancer gjiri. Shumë nga gratë që kanë kancer gjiri nuk kanë faktorë risk të tjerë vetëm se janë gra mbi moshë 50 vjeç.

RISKU

Rreth 70% e kancerit të gjirit ndodh tek gratë, të cilat nuk kanë faktorë që rrisin rrezikun për të zhvilluar kancer gjiri. Kanceri i gjirit është kanceri më i shpeshtë te gratë. Ai mund të shfaqet në çdo moshë, por shumica e rasteve shfaqet në gratë në moshë mbi 50 vjeç. Kanceri i gjirit mund të shfaqet dhe tek burrat, por është shumë rrallë. Ju nuk mund të ndryshoni shumicën e faktorëve të rrezikut për kancer gjiri, si sëmundjet familjare ose menstruacionet në moshë shumë të re. Pyesni mjekun tuaj për ekzaminimet për gjirin që ofrohen në territorin ku banoni. Konsultohuni me mjekun e qendrës suaj shëndetësore për

ISHP: Kategoritë më të riskuara për t'u prekur nga kanceri i gjirit



çdo informacion që ju përkrahë në një shpresë..... se kanceri i gjirit mund të zbulohet në faza të hershme dhe të trajtohet.

DIAGNOSTIKIMI
Nëse jeni një nga këto gra që rrezikoni për kancer gjiri mund të keni mundësi të kryeni teste depistuese në moshë më të re dhe më shpesh se rekomandimet. Të kryeni vlerësim të riskut gjene-tik, disa trajtime parandaluese si marrja e anti-estrogeneve ose kirurgjia profilaktike. Këto ekzaminime për kancer gjiri mund t'ju ndihmojnë ta kapni atë në faza të hershme dhe kur është shumë i trajtueshëm. Është e rëndësishme të dimë se asnjë test depistues për kancerin nuk është 100% i saktë. Për shembull, nëpërmjet një testi depistues ndonjëherë mund të diagnostikohet kancer kur nuk është

kancer, ose nuk diagnostikohet si kancer kur është kancer. Ekzaminimet depistuese shpëtojnë me mijëra jetë. Ekzaminimet më të besueshme që përdoren për diagnostikim të hershëm të kancerit të gjirit janë mamografia dhe ekzaminimi klinik i gjirit. Mamografia është ekzaminimi i gjirit duke përdorur doza të ulëta të rrezeve X. Pamjet e mamografisë tregojnë detaje dhe pamje të gjirit të marra nga kënde të ndryshme. Gjiri vendoset midis dy pjatave plastike, të cilat e shtypin gjirin për ta shtrirë atë. Kjo mund të jetë ɗiçka e pakëndshme, por zgjat vetëm pak sekonda. Shtypja e gjirit ndihmon në marrjen e imazheve sa më të qarta, duke përdorur sa më pak rreze X. Pyesni mjekun tuaj se çfarë ekzaminimesh për gjirin ofrohen në ter-

FAKTORË RREZIKU PËR KANCERIN E GJIRIT:

- Moshë mbi 50 vjeç.
- Pasja e një kanceri gjiri më parë.
- Histori familjare të kancerit të gjirit (veçanërisht me nënën, motrën ose vajzën) të diagnostikuara përpara menopauzës.
- Ndryshimet gjenetike prezente me genin BRCA1 ose BRCA2.
- Histori familjare me kancer të ovarit.
- Femrat që nuk kanë lindur fëmijë ose lindjen e parë e kanë bërë në moshë më të madhe se 30 vjeç.
- Menstruacione në moshë shumë të hershme, para 12 vjeç.
- Menopauzë pas moshës 50 vjeç.
- Përdorimi i mjekimit me hormone (estrogjen + progjesteron) për një kohë të gjatë, më shumë se 5 vjet.
- Densiteti i shtuar i indeve të gjirit (e dukshme në një mamogram).
- Një histori e një biopsie gjiri që tregon një numër të rritur të qelizave jonormale, që nuk janë kanceroze (hiperplazi atipike).
- Trajtimi me rreze të sipërfaqes së gjirit, veçanërisht para moshës 30-vjeçare psh., trajtimi i limfomave Hodgkin.
- Mbipeshja dhe obeziteti, sidomos në menopauzë.
- Përdorimi i tepruar alkoolit.
- Duhanpirja.
- Marrja e kontrceptivëve nga goja e pakontrolluar nga mjeku.
- Dieta dhe ushqimet e pasura me yndyrë shtazore.
- Moskryerja e aktivitetit fizik.

ritonin ku ju banoni. Informimi është pjesë e rëndësishme e kujdesit për trupin tuaj. Informimi ndihmon të njohurit e gjinje dhe mënyrën se si ato ndryshojnë gjatë gjithë jetës suaj.

Këshilla



Pse duhet t'i përdorni gjethet e dafinës

Gjethet e dafinës janë krejt ndryshe nga çdo erzë, ose barishte e thatë që mund të kemi në kuzhinë. Në çdo gatim, të gjitha erëzat dhe barishtet e tjera përdoren dhe konsumohen deri në fund, ndërkohë që gjethet e dafinës duhen hequr nga ushqimi përpara servirjes. Gjethet e dafinës janë të pasura me përbërës bimorë, vitamina dhe minerale plot vlera. Gjethet e dafinës janë efikase në trajtimin e diabetit të llojit 2. Ato ulin nivelet e glukozës në gjak, kolesterolit dhe trigliceridet. Për të përfutur rezultatet maksimale, gjethet duhen shkërmoqur, pluhuri i tyre të përfshihet në ushqim dhe të konsumohet për 30 ditë. Konsumimi i dafinës pluhur do të ulë nivelet e sheqerit në gjak dhe do të rregullojë funksionet e zemrës. Antioksidantët e gjethja e dafinës e ndihmojnë trupin të përpunojë insulinën në mënyrë më efikase. Kjo veti e bën dafinën një zgjedhje të mirë për njerëzit që vuajnë nga diabeti. Gjethet e dafinës ndihmojnë tretjen dhe shmangin çrregullimet në këtë sistem. Nëse

pini çaj dafine, mund të luftoni aciditetin e lartë në stomak dhe të zgjidhni problemin e lëvizjeve të çrregullta të zorrëve. Gjethet e dafinës përmbajnë enzima që mundësojnë shpërbërjen e proteinave dhe rrjedhimisht ato janë një zgjedhje e shkëlqyer për dietat jovegetariane. Merrni 5 gramë me gjethet dafine, shtoni xhenxhefil dhe ziejini së bashku në 200 ml ujë deri sa të mbetet $\frac{1}{4}$ e ujit. Shtoni mjaltë dhe piheni lëngun dy herë në ditë.

VEZI TË TJERA

Gjethet e dafinës janë një mburojë e mirë kundër sëmundjeve kardiovaskulare. Këto gjethet përmbajnë substanca të vlefshme siç janë rutina, salicylates, acidi kafeik dhe fitoushques që forcojnë shëndetin e zemrës dhe përmirësojnë funksionet e saj. Ata që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe ankthi duhet të ziejnë tre gramë me gjethet dafine dhe 3-4 gramë me lule të trëndafilat të egër në 300 ml ujë. Lëngu duhet të ziejë deri sa të mbetet 75 ml e ujit. Kullojeni dhe piheni. Gjethet e dafinës janë efikase kundër infeksion-

eve dhe simptomave të të ftohtit dhe gripit. Në rastet kur vuani nga probleme me frymëmarrjen, zieni 2-3 gjethet dafine në ujë. Lëreni të ftohet për 10 minuta. Zhysni një napë në lëng dhe më pas vendoseni në krahor për ta çliruar nga bllokimet e shkaktuara nga i ftohti, kolla dhe virozat. Çaji i gjethëve të dafinës është efikas kundër temperaturës. Nëse vuani nga teshtimat e përsëritura, zieni disa gjethet dafine në 200 ml ujë deri sa të mbetet $\frac{1}{4}$ e tij. Kullojeni dhe piheni lëngun. Nëse konsumoni gjethet dafine nëpërmjet çajit, përpara fjetjes do të keni një gjumë të mirë dhe të qetë. Ky çaj bën mrekulli. Gjethet e dafinës ndihmojnë kundër infeksioneve dhe gurëve në veshka. Zieni 5 gramë me gjethet dafine në 200 ml ujë deri sa të mbetet 50 ml e tij. Kullojeni dhe lëngun piheni dy herë në ditë. Ky lëng do të parandalojë formimin e gurëve. Gjethet e dafinës largojnë stresin nga lëkura dhe parandalojnë shfaqjen e njollave dhe rrudhave. Hidhni 5 gjethet të thata të dafinës në dy gota ujë. Ziejini lëngun për 2 minuta në një çajnik të mbyllur. Hidhni lëngun e zier dhe mbajeni fytyrën sipër enës, duke mbuluar kokën me një peshqir.



Efektet e mrekullueshme të fikut në organizëm

Të gjitha llojet e fiqve janë të pasur me fibër dietike, minerale si kaliumi, kalciumi, magnezi, hekuri, bakri dhe vitaminat A, B, E dhe K. Fiqtë janë të pasur edhe me sheqerna dhe kanë një nivel të lartë glicemie. Ekspertët rekomandojnë shoqërimin e fiqve me ushqime që kanë nivel të ulët glicemie, siç mund të jenë arrat, bajamet apo perimet. Ngrënia e këtyre ushqimeve së bashku me fiqtë bën që sheqeri të përthithet më ngadalë në gjak. Të freskët ose të thatë, fiqtë janë përdorur në mjekësinë tradicionale për të zbutur dhimbjet e dhëmbit, trajtuar problemet me tretjen, heqjen e toksinave, forcimin e thonjve dhe heqjen e njollave. Fiku rekomandohet për njerëz që vuajnë nga pamjaftueshmëria e hekurit, pasi është një burim i mirë i këtij minerali. Fiqtë rekomandohen për njerëzit që vuajnë nga problemet me tretjen dhe janë në fakt miku më i mirë i sistemit tretës për shkak të përmbajtjes së lartë të fibrës. Rekomandohet që fiqtë e thatë të mbahen në ujë për disa orë dhe më pas të pini lëngun dhe të hani frutat. Fiqtë janë shumë të mirë për të pastruar organizmin nga toksinat dhe janë një ndër ushqimet unike me alkaline. Ato balancojnë nivelet e aciditetit që zakonisht ngrihen kur konsumoni shumë mish ose ushqime të përpunuara. Fiqtë, veçanërisht ato të thatët janë të pasur me kalcium, që është një nga përbërësit më të rëndësishëm që ndihmojnë kockat dhe mbajnë larg sëmundjen e osteoporozës. Lëngu i fikut është efikas kundër kollës së thatë, astmës, fytyrë të lënduar dhe sekrecioneve. Zieni fiqtë në ujë (një ose dy fiq në një filxhan ujë) për disa minuta dhe piheni lëngun disa herë në ditë. Fiqtë ulin tensionin e gjakut falë përmbajtjes së lartë të kaliumit, një mineral që mban tensionin e gjakut nën kontroll. Njerëzit që konsumojnë pak ushqime të pasura me kalium dhe shumë kripë janë të predispozuar të vuajnë nga tensioni i lartë i gjakut. Fiku dhe gjethet e tij ulin nivelet e triglicerideve. Kur ky nivel është shumë i lartë, atëherë po aq janë edhe gjasat që ju të përjetoni një atak në zemër ose goditje në tru. Fiqtë përmbajnë omega-3, omega-6 dhe fitosterolë që ulin nivelet e kolesterolit. Fibra ndërlikohet me kolesterolin dhe e nxjerr atë jashtë trupit.

"Kam vrasë 7 gra", rrëfimi i vrasësit serial në Qipro

Ekzekutoi femrat, mes tyre edhe dy minorene, ish-oficeri: Jam dakord me parburgimin

Ditën e djeshme, gjykata e Nikozias ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" për vrasësin e dyshuar të 7 grave, mes tyre edhe dy vajzave të vogla të moshave 6 dhe 8 vjeçe. Edhe pse ngjarja ka bërë bujë të madhe, është raportuar edhe prej mediave më në zë globale, 35-vjeçari ka dalë thuajse i qetë përpara gjykatësve duke pranuar fajin. Për çudi të të gjithëve, i dyshuari është një ish-oficer i ushtrisë, raportojnë mediat greke. Hetuesit, gjykatësit, prokurorët e kanë përshkruar ngjarjen si



kriminale dhe tmerrshme. Mirëpo, 35-vjeçari është dukur thuajse i qetë kur iu

VRASËSI I 7 GRAVE

"Jam dakord për parburgimin. Kam kryer 7 vrasje. Aq janë, nuk janë më shumë", - ka qenë fjala e ish-oficerit të ushtrisë përpara hetuesve.

dha masa e sigurisë dhe fjalët e tij kanë qenë: "Jam dakord për parburgimin", shkruan gazeta greke "Zougla". Ngjarja u përhap bujshëm si një krim i tmerrshëm, në kufijtë e horrorit. Kjo ka bërë që as-

një avokat të mos e marrë për sipër të mbrojtë të dyshuarin, së paku deri tani. Ajo që ka habitur më shumë është se 35-vjeçari ka treguar vetë se ka kryer 7 vrasje. "Kam kryer 7 vrasje. Aq janë, nuk janë

më shumë", ka qenë fjala e tij përpara hetuesve. Gratë e vrara dhe më tej të hedhura në një liqen nga i riu qipriot janë kryesisht nga Filipinet. Në Qipro jeton një komunitet i tërë nga Filipinet. Kundër 35-vjeçarit rëndojnë një sërë akuzash, 7 vrasje të rënda me paramendim dhe të tjera. Procesi ndaj tij u mbajt me kushte të forta të sigurisë. Burri vrasës ka pranuar se i ka hedhur trupat e viktimave në liqen, pasi i kishte ngarkuar në valixhe. Qindra e mijëra qytetarë kanë protestuar për rastin e rëndë. Ndërkaq, për ngjarjen reagoan edhe politikanët të lartë të vendit, duke e dënuar me forcë atë që ka ndodhur.

SHKURT

Po numëronin fletët e votimit, humbin jetën 270 persona

Më shumë se 270 punonjës në qendrat e numërimit kanë humbur jetën në Indonezi, për shkak të lodhjes së shkakuar nga orët e gjata të punës, duke numëruar me dorë miliona fletë votimi. Lajmi është bërë i ditur nga autoritetet zyrtare të Indonezisë - raporton "BBC". Arief Priyo Susanto, zëdhënës i Komisionit të Zgjedhjeve në Indonezi, tha se 1878 persona të tjerë, pjesë e stafit të qendrave të numërimit të votave ishin ndërë keq. Komisioni i Zgjedhjeve planifikon që të dëmshpërblejë familjet e viktimave me 1930 dollarë, që përfshijnë llogaritë sa pagesa minimale 1-vjeçare. Në total janë rreth 7 milionë punonjësit që po ndihmojnë në numërimin dhe monitorimin e votave të zgjedhjeve të 17 prillit, ku brenda ditës u votua për presidentin, parlamentin dhe bashkitë. Rreth 190 milionë qytetarë votuan në më shumë se 800 mijë vendvotime. Rezultati i zgjedhjeve pritet të shpallet më 22 maj.

Sulm me armë në sinagogën hebreje, 1 i vrarë dhe 3 të plagosur

Është shndërruar në mort restra hebreje e çlirimti nga skllavëria në sinagogën e Kalifornisë. Një besimtare 60-vjeçare humbi jetën dhe 3 të tjerë u plagosën. Mes të lënduarve është edhe një 8-vjeçare izraelite dhe një rabin. Ata u qëlluan me automatik nga 19-vjeçari Xhon Wrenest. Ai u arrestua në vendngjarje nga një polic i kufirit, që ndodhej brenda në sinagogë, i cili iu kundërpërgjigj autorit me armë, por pa e lënduar. Hetuesit thanë se motiv i ngjarjes ishte urretja ndaj hebrejve. Në manifestin e tij të publikuar para sulmit, 19-vjeçari pa rekorde kriminale shkruante se ishte frymëzuar nga Brenton Tarrant, autori i masakrës me armë të muijt të kaluar në dy xhami të Zelandës së Re, ku u vranë 50 besimtarë myslimanë. Wrenest, student i infermerisë, besonte në teoritë konspirative se hebrejtë duan të shfarosin racën e bardhë europiane dhe se Donald Trump ishte vegël e tyre. Shefi i Shtëpisë së Bardhë ngushëlloi familjet e të prekurve nga kjo ngjarje, ndërsa vlerësoi lartë reagimin e policit, që parandaloi të tjera viktime në këtë sulm.

Papa bën thirrje për evakuimin e refugjatëve nga kampet në Libi

Sulm me dron në Tripoli, humbin jetën 9 persona

OBSH: Deri tani janë vrasë të paktën 278 njerëz

Në sulmin e ditës së djeshme me dron, që operohej nga forcat lindore të Libisë, kanë humbur jetën nëntë persona. Sulmi ndodhi në një kamp ushtarak në Tripoli, njoftoi qeveria e Libisë, që mbështetet nga Kombet e Bashkuara. Në mesin e viktimave ishin edhe katër civilë, të cilët po dërgonin furnizime në kampin ushtarak, në momentin kur ndodhi sulmi në orët e vona të së shtunës - tha Mustafa al-Majai, zëdhënës i qeverisë në Tripoli. Nga ky sulm janë plagosur edhe 35 persona të tjerë - thanë zyrtarët. Ende nuk ka koment lidhur me këtë sulm nga forcat lindore, që komandohen nga Khalifa Haftar. Më herët gjatë këtij muaji, Haftar ka urdhëruar forcat e tij, të quajtura Ushtria Kombëtare e Libisë, që të marrin kontrollin e kryeqytetit libian, Tripoli. Të dyja palët po zhvillojnë luftime në periferi të kryeqytetit. Që prej nisjes së luftimeve për kontrollin e Tripolit, sipas Organizatës Botërore për Shëndetësi (OBSH), janë vrasë të paktën 278 persona. Në Libi janë të paktën dy qeveri: njëra me bazë në Tripoli, që udhëhiqet nga Fayet Serraj dhe që ka mbështetjen e OKB-së dhe një qeveri tjetër me bazë në qytetin lindor, Tobruk, të cilës i përket komandanti Haftar. Organizata bëri të ditur se mbi 18.000 njerëz janë zhvendosur si pasojë e luftimeve. Ndërkaq në 5 prill, Khalifa Haftar, komandant ushtarak në Libinë Lindore, nisi ofensivën ushtarake për të kapur kryeqytetin Tripoli, ku gjendet selia e Qeverisë së Pajtimet Kombëtarë të mbështetur nga OKB. Operacioni filloi para "konferencës së dialogut kombëtar", që do të mbahej në Libi nën mbikëqyrjen e OKB-së më 14-16 prill. Libia ka mbetur e përfshirë nga trazirat që nga viti 2011, kur një kryengritje e përgjakshme e mbështetur nga NATO-ja çoi në rrëzimin dhe vdekjen e presidentit Muamar Gadafi, pas katër dekadash në pushtet. Që atëherë, ndarjet politike në vend kanë shkakto-



ar ndarjen e pushtetit, një në qytetin lindor të Al-Bayda, me të cilin Haftar është i lidhur dhe qeveria e mbështetur nga OKB-ja në Tripoli. Nga ana tjetër, Papa Françesku ka bërë thirrje për evakuimin e refugjatëve, të cilët po mbahen në kampet e ndalimit në Libi, teksa luftimet janë duke u përshkallëzuar. Duke folur dje pas lutjeve në Vakitan, Papa tha se refugjatët tashmë janë duke u përballur me kushte të vështira në këto kampe. Sipas tij, këto kushte janë përkeqësuar edhe më shumë, për shkak se luftimet po vazhdojnë. "Bëj apel që veçanërisht gratë, fëmijët dhe të sëmurët të mund të evakohen sa më shpejt që të jetë e mundur, përmes korridoreve humanitare", tha Papa Françesku.

Javën e kaluar, agjencia për refugjatë e Kombeve të Bashkuara evakoi 325 refugjatë afrikanë, të cilët gjendeshin në një kamp të ndalimit në jug të Tripolit, pas përshkallëzimit të dhunës.

SHKURT

Vriten 3 anëtarë të familjes së autorit të sulmeve në Sri Lanka

Babai dhe dy vëllezërit e Zahran Hashim, i cili dyshohet të jetë organizatori i sulmeve vetëvrasëse në Sri Lankë janë vrarë nga policia gjatë një bastisjeje - thanë burimet e sigurisë. Sipas tyre, Zainee Hashim, Rilwan Hashim dhe babai i tyre, Mohamed Hashim janë në mesin e 15 personave të vrarë gjatë një përleshjeje me armë zjarri, pasi forcat e sigurisë hynë në një shtëpi në lindje të vendit, dy ditë më parë. Tre personat shihen në një video që po qarkullon në mediat sociale, duke bërë thirrje që të luftohen të gjithë jobsimtarët. Niyaz Sharif, kunati i Zahran, i ka thënë agjencisë "Reuters" se në këtë video janë dy vëllezërit e Zahran dhe babai i tyre. Autoritetet në Sri Lankë besojnë se Zahran ishte organizatori i sulmeve me bomba në ditën e Pashkëve, ku u vranë mbi 250 persona. Sulmet u kryen në kisha dhe hotele në mbarë vendin. Policia ka konfirmuar se Zahran ka vdekur gjatë sulmit vetëvrasës në hotelin "Shangri-La" në Colombo. Ai ishte shfaqur në një video të grupit militant, Shteti Islamik, duke marrë përgjegjësinë për këto sulme të koordinuara. Që prej sulmeve të 21 prillit në Sri Lankë, rreth 10 mijë ushtarë janë dërguar në mbarë vendin për të ofruar siguri dhe për të kryer bastisje. Policia thotë se ka arrestuar dy persona të dyshuar më 27 prill, duke bërë që numri i personave të arrestuar lidhur me sulmet vdekjeprurëse të shkojnë në mbi 100, përfshirë këtu edhe shtetas të Sirisë dhe Egjiptit.

Spanjollët votojnë në zgjedhjet e përgjithshme

Sanchez, e ka paraqitur veten si person që kundërshton rritjen e së djathtës ekstreme. Sipas sondazheve, Partia Socialiste e kryeministrit Sanchez do të udhëheqë në këto zgjedhje, por nuk do të mund të qeverisë e vetme pa koalicionin, pasi asnjë grup nuk do të mund të fitojë një shumicë në parlament. Një sondazh i gazetës "El Pais"

tha se Partia Socialiste do të fitojë 30 për qind të votave, pasur nga Partia Popullore Konservatore me 20 për qind, Cuidadanos e qendrës së djathtë dhe partia e majtë, Podemos me nga 14 për qind. Ndërkaq, lëvizja "Vox", sipas këtij sondazhi pritet të fitojë rreth 11 për qind të votave. Një nga çështjet që ka mbizotëruar fushatën zgjedhore

është e ardhmja e Katalonjës. Ky rajon gjysmëautonom kishte mbajtur një referendum për pavarësi në tetorin e vitit 2017 dhe kishte shpallur pavarësinë nga Spanja disa javë më vonë. Dhjetëra liderë të Katalonjës, që atëherë janë gjykuar në Madrid dhe përballen me një sërë akuzash, përfshirë rebelim dhe kryengritje. Javë më parë kryeministri spanjoll, Sanchez, kishte deklaruar se nëse Katalonia përsërit përkëqjet e saj për pavarësi, ai do të përdorë "forcën" për ta parandaluar një gjë të tillë.

Media gjermane: Ja çfarë kërkon presidenti kosovar

Samiti i Berlinit, Thaçi: Serbia duhet të na njohë pa kushte

Agjencia e lajmeve "DPA": Pritet një dinamikë e re në takim

Ditën e sotme pritet të mbahet samiti në Berlin, ku do të diskutohet ndër të tjera edhe për marrëveshjen Kosovë-Serbi. Nderkaq, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka folur për agjencinë e lajmeve gjermane "DPA" në prag të takimit të përfaqësuesve të shteteve të Ballkanit Perëndimor me kancelaren Angela Merkel si dhe me presidentin e Francës, Emmanuel Macron. Ai theksoi për median gjermane se sot do t'i kërkohej Serbisë që të njohë pavarësinë e vendit pa asnjë kusht shtesë. "Serbia duhet të njohë shtetin e Kosovës pa asnjë kusht", ka shtuar ai. Sipas "DPA"-së, Presidenti i Kosovës do të kërkojë nga Merkel dhe Macron që t'ia bëjnë të qartë Aleksandër Vuçiçit këtë fakt dhe ta detyrojnë atë të ndërmarrë hapa konkretë për njohjen e pavarësisë. Agjencia gjermane e lajmeve pohon se në këtë samit pritet të marrin pjesë liderët e Ballkanit Perëndimor, ku synohet që të ketë një dinamikë të re në dialogun Kosovë-Serbi. Presidenti Thaçi, sipas kësaj agjencie, thotë se është i gatshëm të vazhdojë dialogun me Serbinë, por pa kushte. "Dialogu nuk duhet të kushtëzohet", ka thënë ai, duke iu referuar kushtëzimeve të Beogradit. Samiti i Berlinit po përcillet me interes të lartë nga të gjithë aktorët politikë. Në këtë takim do të shtrohen në tavolinë çështje të ndjeshme, kryesisht të atyre me Serbisë dhe Kosovës. Gjithashtu, Presidenti i Republikës së Kosovës zbardh disa nga temat e samitit të Berlinit. Thaçi thotë se hapësirë e veçantë do t'i jepet dialogut Kosovë-Serbi, pastaj përmend se do



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

t'i kërkojë Merkelit liberalizimin e vizave dhe do të kërkojë llogari për gjenocidin serb gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ai shkruan se nëse nuk ndodh asnjëra nga këto, takimi do të jetë zhgënjës. "Do të konfirmojmë përkushtimin tonë për të vazhduar pa kompromis luftën kundër radikalizmit, terrorizmit dhe çdo lloj ekstremizmi", thotë Presidenti i Kosovës.

POSTIMI I THAÇI

"Këto ditë kam vazhduar konsultat e fundit me partnerët ndërkombëtarë për konferencën në Berlin, të

ftuar nga kancelarja Merkel dhe presidenti Macron. E mirëpre rritjen e angazhimit të Gjermanisë dhe Francës rreth Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, si dhe Kosovës në veçanti. Në këtë takim do të vlerësohet progresi i deritashëm. Takimi i Berlinit nuk do të sjellë një proces të ri, por do të kërkohej mundësi për zgjidhjen e problemeve, duke marrë shtesë marrëveshjen e suksesshme ndërmjet Maqedonisë Veriore dhe Greqisë. Në takim theks i veçantë do t'i jepet mundësisë së vazhimit të

dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare, që do të sjellë stabilitet dhe më të madh në Ballkanin Perëndimor. Po ashtu, pres nga kancelarja Merkel dhe presidenti Macron që të tregojnë mbështetje për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, si respektimin e kontratës ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Kosova i ka përmbyshur të gjitha kriteret dhe e meriton lëvizjen e lirë si të gjithë qytetarët tjerë të rajonit dhe kontinentit. Nëse diçka e

tillë nuk ndodh, takimi i Berlinit do të jetë zhgënjës për qytetarët e Kosovës. Në këtë takim do të kërkojë edhe dënimin e gjenocidit të shtetit të Serbisë në Kosovë, në vitet 1998-1999. Ne do të fokusohemi edhe në mundësitë e bashkëpunimit ekonomik dhe në forcimin e rendit dhe ligjit, në veçanti në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Do të konfirmojmë edhe përkushtimin tonë për të vazhduar pa kompromis luftën kundër radikalizmit, terrorizmit dhe çdo lloj ekstremizmi".

HASHIM THAÇI

"Serbia duhet të njohë shtetin e Kosovës pa asnjë kusht. Dialogu nuk duhet të kushtëzohet. Do të konfirmojmë edhe përkushtimin tonë për të vazhduar pa kompromis luftën kundër radikalizmit, terrorizmit dhe çdo lloj ekstremizmi", thotë Presidenti i Kosovës.

SHKURT

"Al Jazeera": Si i vranë serbët 376

shqiptarë në Mejë

Media prestigjioze "Al Jazeera" ka shkruar rreth masakrës së Mejës, duke kujtuar sesi më 27 prill 1999, forcat serbe vranë 376 shqiptarë etnikë, myslimanë e katolikë, ndërsa po kërkonin për strehim. Me qindra njerëz në Mejë kanë kujtuar këtë masakër, një ndër më të mëdhatë të kryera nga forcat serbe në Kosovë gjatë kohës së luftës. Kjo masakër është e disata nga të shumtat që kanë kryer forcat serbe në Kosovë. Konflikti në Kosovë në fund të shekullit XX la të vdekur më shumë se 13 mijë persona. Sali Aliaj ishte një nga 52 viktimat në masakrën e Mejës. Aliaj kishte qëndruar në Kosovë, ndërsa familja e tij kishte ikur në drejtim të Shqipërisë për të gjetur strehim. Burrat u ndanë nga gratë e fëmijët dhe u ekzekutuan në një fushë të afërt. "Ishte një ditë e zezë. Humba babanë në masakër. Mund të kisha vdekur edhe unë, por për falë Zotit jam gjallë", thotë Muharremi, djali 35-vjeçar i Sali Aliajt. Ai e mban mend momentin e tmerrshëm të vrasjes së babait, ndërsa kujton fjalët e tij të fundit. "Babanë e mbaj mend në momentet e fundit të jetës së tij. Ai kishte një trishtim të thellë në fytyrë. Mbj mend se ai kishte edhe lumturë, për faktin se unë arrija të shpëtoj. Mendonte se ishte fat që të vdishe vetëm njëri", deklaroi Muharremi. 35-vjeçari tashmë është emigrant në Gjermani, vend ku jeton një komunitet i tërë nga Meja. Të mbijetuarit kujtojnë tmerrin, duke thënë se serbët në fshat ishin të pamëshirshëm, duke vranë edhe gra e fëmijë. Në memorialin për të kujtuar masakrën në Mejë morën pjesë Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, të dy të dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Në kujtim të kësaj dite, në memorial ishte edhe ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Philip Kosnett.

Serbët, thirrje nacionaliste për Kosovën në Jerusale

Një grup serbësh, të gjenur në Jerusale, me rastin e festës së Pashkëve, nuk kanë kursyer thirrjet nacionaliste për Kosovën. Media beogradase "B92" thotë se organizimi bëhet nga Kisha Ortodokse e Serbisë. Ndërsa në rrjetet sociale garkullonte një video, ku shihen serbët duke kënduar për Kosovën dhe kundër pavarësisë së saj. Serbët po këndonin këngë ndërsa po hynin në kishë, kurse në duar mbajnë kryqe të mëdha. Kënga që këndonin titullohet "Oj Kosovë, oj Kosovë, vendi ynë i dashur". Kjo nuk është hera e parë që serbët veprojnë në të tillë mënyrë.

Serbët provokojnë bukëpjekësin shqiptar, i hedhin kokë derri

Bëri simbolin e shqiponjës, dhjetëra qytetarë në Beograd protestojnë: Të largohen!



vendi i ngjarjes. "Harmonia është disfatë e djallit", thuhet në tejt aty. Ky postim ka marrë dhjetëra mesazhe përkrahëse nga serbët e tjerë. Nderkaq, në rrjetet so-

cialë janë shpërndarë disa fotografi dhe video ku qytetarët në Beograd po bëjnë një protestë ndaj bukëpjekësve shqiptarë që ushtrojnë aktivitetin atje.

Serbët shprehen se janë ndër të provokuar nga një foto ku shfaqej një bukëpjekës, i cili bënte shqiponjën dykrenare. Protestues dolën për të protestuar kundër një bukëpjekësi shqiptar dhe kërkojnë largimin e tyre nga kjo lagje. Ata brohorisin se Kosova është Serbi dhe thoshin se bukëpjekësit janë provokatorë. E tëra ka nisur pas një fotoje e bërë muaj më parë, që i ka kushtuar pronarit të furrës "Roma". Borca është një lagje e kryeqytetit serb, rreth 20 kilometra nga qendra. Shqiptarët nga Kosova kanë furra gjithandej, përf-

shirë edhe disa aty. Banorët e kanë parë si provokim shqiponjën dykrenare dhe ftuan banorët për protesta. Në rrjetet sociale ka dalë fotoja me komentin që ky pronar ofendon serbët me foton e tij dhe kjo për serbët është e papranueshme. Disa dhjetëra protestues kanë dalë që herët në mëngjesin e ditës së djeshme për t'u thënë bukëpjekësve të ikin që aty. Bukëpjekësit shqiptarë janë mbyllur në shtëpi, ndërsa në vend ka arritur edhe policia dhe forcat speciale kanë qenë në gatishmëri. Dy raste të tilla kanë ndodhur gjatë muajt e fundit kur bukëpjekësit në njëfarë forme u dëbuan nga Serbia. Përveç protestave, nuk ka pasur reagime nga zyrtarët e shtetit.

Dhjetëra banorë të një lagjeje në Beograd, pasditën e së shtunës kanë bllokuar furrën e një shqiptari, vetëm pse ai ishte shfaqur në "Facebook" me një foto ku bënte shqiponjën. Vitrina e lokalit në pjesën e tij të jashtme është mbushur me letra që mbajnë hartën e Kosovës nën flamurin serb. Në to bëhet thirrje se "harmonia është disfatë e djallit". "Sapo është bllokuar furra e shqiptarëve në Borçe, për të shkak të propagandimit të Shqipërisë së Madhe. Stop prodhimeve shqiptare në Serbi", thuhet në tektin e një përkrahimi në një faqe në "Instagram", që ka postuar edhe fotografi nga

Opinion

i Ditës

Donkishotët e integrimit

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... të vizave për Shqipërinë nuk ka asnjë pasojë konkrete për qytetarët tanë. Kjo, për faktin se nevojitet një shumicë e thjeshtë vendesh anëtare të Bashkimit Evropian (parlamente të tyre) që t'ia kërkojnë këtë Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian. Mirëpo ai dëshmoi dy realitete shqetësuese për integrimin tonë. Që qëndrojnë si shtëpitë Damokleu mbi të. I pari nuk ka të bëjë me ne. Ka të bëjë me rritjen e forcave populiste dhe ekstremiste (të skajshme) edhe në Evropën Perëndimore, të cilat janë kundër emigrantëve dhe zgjerimit të Bashkimit Evropian. Për këtë frymë të re përjashtuese duhet të përgatitemi mirë. Holanda është një vend tipik i shtimit të ndikimit të këtyre forcave politike. Në maj 2018, anëtarë të parlamentit holandez e vunë veten në një pozicion gati qesharak me vizitën e tyre disaorëshe në Tiranë për të hetuar "në thellësi" situatën e vendit. Një mision "faktmbledhës", që asnjë parlament tjetër nga 27 vendet e tjera anëtare të BE-së nuk e mori mundimin ta ndërmerre, për të gjykuar nëse do të duhej të kishte bisedime për mundësinë e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Pak veta tek ne në Shqipëri e lexuan të plotë këtë vizitë fishekzjarr si fitim pikësh të partive holandeze populiste dhe përjashtuese të perspektivës së zgjerimit të BE-së. Këto parti kanë numra të rëndësishëm përfaqësues në parlamentin holandez. Me vendimin e 16 prillit të këtij viti, ky parlament e vendosi veten në pozicion absurd e disi qesharak, por kuptimplotë për forcat populiste në BE. Natyrisht që ka ar-



syje të ligjshme për t'u shqetësuar me rritjen e fuqisë organizuese të kriminalitetit shqiptar në vendet evropianoperëndimore, sidomos në Belgjikë, Holandë dhe Britani të Madhe. Mirëpo për këtë nuk ka pse të kërkohej të izolohen të 2.5 milionë qytetarët e një vendi. Nuk

është rruga e duhur. Rruga efektive do të ishte një bashkëpunim më i thellë me policinë shqiptare dhe organet e hetimit në vendin tonë, për të shkatërruar bazat nga ku ushqehen e gjallojnë grupet kriminale shqiptare në vendet e BE-së. Njëllaj sikurse, me të drejtë,

shtetet anëtare të BE-së nuk kanë kërkuar të izolohen të 12 milionë rumunët, edhe pse bashkëqytetarë të tyre janë kontingjent shqetësues i krimit, vjedhjeve dhe trafikut të drogës në vendet evropianoperëndimore. Mirëpo jetojmë në një kohë kur fryn një erë e fortë

populizmi përjashtues për familjen e madhe evropiane dhe në prag të zgjedhjeve të Parlamentit Evropian. Realiteti i dytë që na përket vetëm në është ndikimi i disa politikanëve tanë në vendimin e parlamentit holandez. Kjo është e rëndë, shumë e rëndë. Madje e pafalshme. Këtë ndikim e dëshmoi raportuesi i Parlamentit Evropian për Shqipërinë, Knut Fleckenstein, kur pohoi për një të përditshme shqiptare se mocioni i parlamentit holandez mbështetet nga disa politikanë shqiptarë. Çdo akuzë ndaj fuqisë krimprodhuese të vendit tonë dyfishohet në peshën dhe imazhin e gjoja vërtetësisë së saj, kur shoqërohet me pohime nga politikanë të vendit që akuzohet, pavarësisht se në opozitë. Një lëvizje të tillë qytetarët shqiptarë nuk mund ta falin. Ata nuk janë budallenj. Përkundrazi. Janë shumë të ndjeshëm dhe syçelur; sa herë bëhet fjalë për interesin e integrimit tonë në familjen e madhe evropiane, që është interes kombëtar. Dhe të shkohet kundër këtij interesi është të bësh harakiri me besimin tek votuesit e tu këtu. Ata politikanë që për inat të qeverisjes së sotme tek ne shkuan në shtratin e hedhjes së papërgjegjshme të baltës mbi Shqipërinë dhe kriminalizimit të pabazë dhe të pabesë të saj, nuk do të kenë jetë të gjatë politike këtu. Është vërtetë gjynah që nuk arrijnë të kuptojnë donkishotizmin e tyre grotesk dhe ogurzi për gjasat tegruesse të vendit. Ironia dhe paradoksi është kur e justifikojnë këtë veprim Neroni me dëshirën që gjoja kanë për të përkrahur integrimin e Shqipërisë në BE. Nuk e kuptojnë se kush godet të ardhmen tonë evropiane, qoftë edhe si padashur e verbërisht, është i destinuar të tretet në radarin e interesave të votuesit të thjeshtë shqiptar.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni *i* Ditës

Autoritarizmi psikopatik, krimi dhe Edi Rama në mes!

Nga Petrit Vasil

(vijon nga faqja 1)

... ligj, si dhe të drejtën për të vënë firmën në çdo shkresë anti-ligjore shteti, me qëllimin e vetëm, grabitjen e parave e interesave publike. Është edhe psikopatik, sepse nuk bazohet as te logjika, as tek ekuilibrat e mëdha shoqërore, as te politika e arsyes, por thjesht te histeria e grabitjes dhe e padijes. I gjithë autoritarizmi psikopatik ka me vete në çdo cast e në çdo veprim, krimin. Ka krimin kur grabit zgjedhjet, ka krimin kur grabit miliarda lekë para shtetërore me koncesione e tendera, ka krimin kur dhuron qytetarët, ka krimin kur bëhen zgjedhje në universitete, ka krimin kur i mbyll gojën drejtësisë e prokurorisë, ka krimin kur ha dreka e darka me ta, ka krimin kur shantazhon njerëz të ndershëm, që e duan këtë vend. Mes autoritarizmit psikopatik dhe krimin qëndron Edi Rama, zotëruar e shpërdorues i pushtetit në njërin anë dhe përdorues e mbështetës i krimin nga ana tjetër. Edi Rama nuk u ka sjellë asgjë të mirë shqiptarëve. Ai erdhi dhe po ikën duke lënë pas një model të pacipë hajdutërie shtetërore. Ai erdhi dhe po ikën, por qindra drejtuesve shtetërorë të të gjitha niveleve, do t'u dalë për shumë kohë gjumi natën, si bashkautorë dhe bashkëpërgjegjës të kësaj hajdutërie të udhëhequr nga Edi Rama. Ai erdhi dhe po ikën duke lënë pas një destrukturim shkatërrimtar të ekzekutivit edhe si strukturë, edhe si nivel profesional, edhe si pushtet thellësisht i korruptuar, edhe si dhunuese e pashembullt e ligjit. Ky ekzekutiv është pjella më e keqe e bashkimit të autoritarizmit psikopatik me krimin dhe Edi Ramën në mes tyre si ura lidhëse mes të dyve. Blerja e zgjedhjeve përmes krimin është provuar tashmë publikisht, juridikisht e moralisht. Çdo kryeministër me minimumin e psikikës dhe ndërgjegjes normale do të ishte vetëlarguar me kohë. Do të ishte larguar siç kanë bërë shumë kryeministra në Shqipëri dhe në botë, të cilët nuk kanë qenë përgjegjës asfale të një kriminalizimit të tillë si i Edi Ramës, por vetëm sepse tensionimet politike ua kanë kërkuar, janë larguar. Por, Edi Rama i ka duart e lidhura, sepse pushtetin ekzekutiv e ka kribur në përgjegjësi të rënda pa shpëtim dhe litarët e krimin i rrinë pas qafe. Sot ky autoritarizëm psikopatik, i bërë njësh me krimin është një precedent, që Europa e pas-Luftës së Dytë Botërore nuk e ka parë në asnjë vend të saj. I quajtur Kolumbia e Europës, ky është pushteti i Edi Ramës dhe njëherazi precedenti më i padëguar, më i



rrezikshëm, modeli më shkatërrimtar për demokracinë dhe si e tillë, kjo lloj qeverisjeje duhet shembur me çdo mjet. Djegia e mandateve të opozitës ishte dhe mbetet kushtimi për asgjësimin e shtetit demokratik në të gjitha shtyllat e tij, kriminalizimit shtetëror pa precedent dhe të kolumbizimit të Shqipërisë nga rilindja e Edi Ramës. Asgjësimi i zgjedhjeve dhe asgjësimi i hetimit të prokurorisë për krimin zgjedhor të bërë publik nga VOA është fshëja e precedentit e krimin ek-

toral, që polli pushtetin e kriminializuar të Edi Ramës. Çdo qëndrim, aksion politik dhe veprim publik sot natyrshëm do të jetë i paprecedent, sepse e tillë e paprecedent dhe shumë e rëndë është situata e krijuar nga autoritarizmi psikopatik i bërë njësh me krimin e Edi Ramës. Sot Edi Rama flet me orë të tëra kundër opozitës, por nuk guxon të flasë asnjë minute kundër krimin. Sot Edi Rama sërisht flet me orë të tëra kundër opozitës, por asnjë minutë kundër korrupsionit; sot ai flet me orë të tëra kundër

qytetarëve protestues, por asnjë minutë kundër kriminelëve dhe trafikantët që rrëmbejnë pronat tek "Unaza e Re", te Bregu i Lumit. Sot flet me orë të tëra për Monikën dhe Lulin, por as guxon t'u zërrë emrin me gojë kriminelëve anë e mbanë vendit. Sot arreston fëmijë, gra e të moshuar, por as nuk guxon të arrestojë e as t'u afrohet kriminelëve e trafikanteve. Vetëm një psikopati autokratike kriminale, që është ulur në karrigen e kryeministrit mund ta guxojë një kriminalizim të këtyre përmasave. Ndaj, të gjithë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në Europë e SHBA, në politikë e diplomaci, në shqip dhe në anglisht duhet të pranojnë se mbyllën sytë përpara këtij modeli paprecedent të kriminalizimit shtetëror. Sot të gjithë e kanë për detyrë të mbështesin betejën e shqiptarëve për ta zhbërë dhe shkatërruar këtë model kriminal shtetëror me çdo mjet dhe veprim që natyrshëm do të jetë demokratik dhe asimetric, sepse autoritarizmi psikopatik dhe krimin, me Edi Ramën në mes do të thotë mbretërimi i antishtetit.

Edi Rama nuk u ka sjellë asgjë të mirë shqiptarëve. Ai erdhi dhe po ikën duke lënë pas një model të pacipë hajdutërie shtetërore. Ai erdhi dhe po ikën, por qindra drejtuesve shtetërorë të të gjitha niveleve, do t'u dalë për shumë kohë gjumi natën, si bashkautorë dhe bashkëpërgjegjës të kësaj hajdutërie të udhëhequr nga Edi Rama.

HOROSKOPI

DASHI

Mos pranoi avantazhe të padrejta, por qëndrojeni besnik karakterit tuaj të vërtetë. Ju nuk jeni mbështetur kurrë te mashtrimet për të arritur qëllimet tuaja dhe nuk ka absolutisht asnjë arsye pse të filloni ta bëni këtë tani.

DEMI

Është koha të filloni të planifikoni aventurën tuaj të ardhshme të udhëtimit. Koha po kalon dhe këto plane nuk do të realizohen vetvetiu. Duhet të veprojnë shpejt, nëse do të shkoni atje ku dëshironi pa paguar shumë para.

BINJAKET

Përpiqini të mos tregoheni shumë emocional gjatë një bisede sot. Nëse dikush flet pa menduar ose thotë diçka provokuese, mos kaloni menjëherë në mbrojtje. Duhet të qëndroni objektiv dhe racional në lidhje me situatën.

GAFORJA

Nëse jeni duke menduar për të bërë një ndryshim në jetën tuaj, bëjini gjërat ngadalë. Transicionet graduale janë shumë më të favorshme se sa ndryshimet e menjëherëshme. Duhet të ruani ekuilibrin në jetën tuaj.

LUANI

Nëse statusi i një marrëdhënieje romantike nuk është shumë i qartë, duhet të hapni sytë pak më të shumë. Nëse nuk i shikoni gjërat ashtu siç janë me të vërtetë, mund të jetë sepse keni frikë se pamja nuk është aq rozë sa dëshironi.

VIRGJERESHA

Jini të përgatitur për disa reagime të pazakontshme sot nga dikush, opinionin e të cilit e vlerësoni pa masë. Ju jeni gjithmonë të përgatitur për të dëgjuar të vërtetën, por e vërteta nuk mund të shprehet shumë në mënyrë diplomatike sot.

PESHORJA

Sot tregohuni më i hapur për veten tuaj. Mos keni frikë t'i tregoni dikujt diçka të sikletshme për veten. Nxjerrja e kësaj sekreti nga 'gjoksi' do t'ju ndihmojë që të ndiheni më mirë. Nëse jeni duke u përpjekur të afroheni me dikë, ndani sekretet tuaja.

AKREPI

Përpiqini të shmangni temat e mëlzëzshme nga bisedat me njerëzit që ju rrethojnë. Qëndroni me ide interesante dhe koncepte zbavitëse me të cilat mund të lidhen të gjithë. Në aspektin profesional duhet të keni më shumë variancion për të pasur ritmin optimal.

SHIGJETARI

Përdorni kreativitetin tuaj dhe shprehni veten në mënyrën më të mirë që dini. Merrni me art, letërsi, kërcim dhe gjithçka jetë që ju përshatojnë për të shprehur ndjesitë tuaja. Nëse i mbanni emocionet brenda ose i maskoni ato, marrëdhëniet tuaja mund të kalojnë në ngjërë.

BRICJAPI

Për të pasur rezultate më të mira duhet të ndryshoni sjelljen. Nëse deri tani keni qenë miqësor, provoni të jeni paksa të ftohtë. Ndoshta njerëzit do t'ju vlerësojnë më shumë. Një taktikë e re patjetër që do të sjellë ndryshime pozitive sot në jetën tuaj.

UJORI

Dikush në jetën tuaj tani mund të jetë karizmatik, por sjellja e tij e paqartë në lidhje me dashurinë me të vërtetë ka filluar t'ju bezdisë. E gjithë kjo paqartësi po fillon të duket pak mashtruese.

PESHQIT

Ka diçka që mungon në jetën tuaj dhe që nuk po arrini ta identifikoni. Kaloni pak më shumë kohë vetëm, sepse gjërat më të suksesshme shpeshherë arrihen në vetmi. Në dashuri keni nevojë për një impuls të ri.

"EPIRI I VERIUT" DOSSIER

Zyrtarizimi i platformës shovene helene "Megali Idea"

Si u krijua më 1914 qeveria e përkohshme vorioepirote

Zografi kërkoi që edhe Lunxhëria të shpallej zonë pakice greke



Dr. Hasan Luçi

(vijon nga numri i djeshëm)

M e histeri kanceroze pa shërim veprimi dhe ue rodeputetja qipriote, Eleni Theocharous, e cila ishte e pranishme në Bularat dhe dashka të grijë sallatë e hajë çorbën e saj edhe në Parlamentin Europian për të akuzuar Shqipërinë për vrasjen e Kacifas dhe të kërkujë autonomi për pakicën greke, dhe të përdorë veton për moshapjen e bisedimeve për t'u pranuar Shqipëria në BE, veç që ofendoi kryeministrin E.Rama, pasi ajo e rregulloi Qipron e vet dhe do na vërë edhe ne në udutin e saj pa tru! Pasi u shpall e padëshiruar nga Shqipëria, ajo bëri deklaratën cmen-darake, se e kishte për nder dhe nuk do të përkulet për pasionin e saj për të drejtat e njeriut të Epirit të Veriut. Komentit është i tepërt. Parlamentin Europian ka faj se nuk po e ndan mirë shapin nga sheqeri për marrëdhëniet me vendeve anëtare, duke lejuar Greqinë të vijojë politikën absurde antishqiptare në shekuj dhe duke lënë pa rishqyrtuar padrejtësitë tragjike që na janë bërë nga paraardhësit, por edhe në këto vite të tranzicionit po tragjik shqiptar, ku grekët kanë shtrirë dorën e zezë në shumë drejtime si në politikë, ekonomi, kulturë. Kanë uzurpuar kishën shqiptare me Jaullatosin, priftërinjtë e kishat e shumta, po përdorin në mënyrë kriminale një pjesë servile të pakicën greke për të arritur synimet e tyre dhe për të zgjeruar zonat e pakicës greke sipas oreksit të "Idesë së madhe" helene dyshekullore. BE-ja duhet të



zgjohet, të jetë vigjilente dhe ta disiplinonjë Greqinë, e cila në fakt nuk ka realizuar as ato detyra që na kërkon ne. Greqia kërkon nga Shqipëria edhe qigra në hell. Greqia nuk njihet tjetër shqiptare e pronat e shqiptarëve nën kolonizimin grek, nuk njihet as të drejtat e liritë njerëzore të shqiptarëve (arvanitëve) në Greqi, ku ka 696 fshatra, ku në shtëpi flitet shqip, ndërsa në publik ua ka ndaluar ligjërisht etj., mizori. Mërgimtarëve shqiptarë atje u ndërton emër e mbiemër me dhunë duke i greqizuar, i detyron të marrin shtetësinë greke, fëmijët i greqizon etj., pa fund. BE-ja i bën sehir e fresk Greqisë. BE nuk reagon ndaj deklaratës së zvmministre greke, Cude-ru, e cila pohoi se "çamët ortodoksë kishin fituar ndërgjegje kombëtare, ndaj ish-in grekë" ('Drita', 13.09.2003 f.13). Sa bukur e ke gjetur alibinë moj shejtane, se nuk ta thotë dot goja gjenocidin mëse fashist kundër çamëve! Po më i zgjuari se ti është ishte ministri i shtetit, Kuvellas, i cili në stadiumin olimpik të Athinës, ku fitoi PDhima nga Himara, u "kujtoi" të pranishmëve se, "se do të vinte koha kur do të çlironin vëllezërit e tyre të pushtuar në Shqipëri!". Por, ai harroi t'u thoshte se nuk ia mban kujt për këtë çmenduri atje! Më 2004 gjenerali ultranacionalist grek, Grilakis deklaroi se "Kryepeshkopi Serafin më kërkoi të drejtoja luftën vorio-epirote. Kërkuam ndarjen veri-jug të Shqipërisë. Nuk pranova

pasi isha këshilltar i kryeministrit..." (gazeta 'Ballkan', 09.05. 2004 f.3). Së fundi, bomba e ish-ministrit të Jashtëm, Kotzias, në tetor 2018 se "ushtria greke nuk njihet kufijtë me Shqipërinë"! Greqia kërkoi edhe zgjerimin e shelfit kontinental në 12 milje! Këto deklaratat politike greke janë nxitje për të gatuar ngjarjet në Shqipëri sa herë u teket. Por e meritonjë t'u përgjigjemi me humorin korçar: nga të tria, do të merrni atë më të gjatit! Grekë e serbë, malazezë e maqedonë harrojnë deklaratën e Eguard Gejt: "Ne i copëtuam kufijtë e Shqipërisë me të drejtën e forcës së të madhit mbi të voglin". Ja që kemi argumente bindëse edhe nga një diplomat mafioz kolonialist anglez. Qeveria e Sali Berishës e Aleksandër Meksit u ngazëllyen nga aleanca greko-shqiptare, duke nënshkruar traktatin e miqësisë (në fakt të zisë, H.L) se sa herë pati interes Greçia e kërcënoi Shqipërinë me veton për integrim dhe i lejuan dalëngadalë përfitimet në çdo drejtim nga 1992-1997 dhe 2005-2013 me kishat, shkollat, varrezat dhe deri të shitja e detit për naftën (se Greçia s'ka hiç det H.L). Greqia sh-ton armatimet e diversionit kundër Shqipërisë. Sali Berisha urdhëroi Genc Pollon të botonte libra për pakicën greke e shkollat greke në jug, duke përfshirë edhe Himarën (se e ka qef shejtani jugun si në 1997-H.L) dhe harroi Çamërinë, që e


shënoi formalisht në traktatin e miqësisë, kur 200 mijë çamë presin zgjidhjen e problemeve të tyre etnike e ligjore! Nënshkruesi i shitjes së detit në 2009-ën, Lulëzim Basha, e lumturoi ministren Bakojanis. Basha u takua edhe me lobin greko-amerikan për Himarën, ku ishin 3 deputetë grekë, por heshti si buf! Sali Berisha çirret e shtirret atdhetar, por i ka favorizuar grekët politikisht, siç bëri me serbët si në pushtet edhe në opozitë, duke akuzuar PS edhe për çka nuk ka bërë, ndërsa aleatët e vet PBDNJ, Omonia, Mega etj., i le të lirë të vepronjë në bashkëpunim me "Agimin e Artë", apo organizatën terroriste 'Mavi', që ka edhe celula në vendin tonë që nga vitet '90-të edhe "Agimin e Artë". Disa nga presidentët a kryeministrit shqiptarë nuk kanë reaguuar as kur grekët u grisin pasaportat shqiptarëve apo u vënë "fshesën" emigrantëve atje etj., ose reagojnë me humor, ndërsa grekët me fyerje e akuzat qelbëse. Për çështjen çame, asnjë fije reciprociteti mes dy vendeve dhe bënë çorbë në Kuvendin tonë kur u paraqit rezoluta! Në tekste greke të shkollës edhe në 2004 shkruhet se "Shqipëria ka ndihmuar fashizmin" etj., etj., kurse ne na kërkojnë të pastrojim tekste ku flitet për gjenocidet greke etj.. Por, zyrtarët tanë edhe kur reagojnë as ngrohin, as ftohijn. Konsujtë e ambasadorët grekë vepronjë si guvernatorë, por lihen të livadhisin si edhe

priftërinjtë e agentura e tyre. Sërish heshtje. Shteti shqiptar duhet lavdëruar kësaj here për masat që mori kundër terroristit në Bularat për vetëmbrojtje dhe për hetimet e terroristëve e vorio-epirotëve e grekëve që morën pjesë në ato ngjarje të shëmtuara antishqiptare, përfshi arrestimet e bëra e ndjekjen penale të lirë apo në mungesë. Bëri mirë që jo vetëm dha sqarime edhe kryeministri Edi Rama, por edhe Ministria e Jashtme dhe vendimet e Ministrisë së Brendshme për fajtorët në Bularat, por u duhet ndaluar përgjithmonë hyrja kujtdo që vjen me mision antishqiptar në vendin tonë. Shërbimet sekrete shqiptare duhet të mobilizohen në maksimum për të zbuluar e parandaluar çdo veprimtar antishqiptar nga qarqet e ndryshme greke si "vorio-epirotët", "Agimin e Artë", "Mavi" etj., të vjetër e të rinj, duke hapur edhe arkivat e vjetra e plotësuar të rejtat me çdo veprim antishqiptar, brenda e jashtë vendit, vetëm e vetëm për qëllime vetëmbrojtjeje, pavarësisht gjeopolitikës së sotme të integritit në rrafshin euroatlantik. Nuk duhet harruar se është vetëvendosja e popujve e para dhe jo integrimi, që kërkon të mos prekë mosndryshimin e kufijve të ndarë padrejtësisht në mënyrë tragjike, duke synuar asimilimin e popujve të vegjël në vorbullën e të mëdhenjve sundues. Kufijtë kombëtarë duhet t'i trashëgojnë brezat tanë e të jetojnë në trojet e veta etnike natyrore e historike. Demokracia globale është një lojë e përkohshme, jo e përjetshme, na mëson historia njerëzore. Shqiptarë të kundododhur, jini vigjilentë dhe bashkohuni për t'u bërë ballë agresioneve të huaja, siç na kanë mësuar traditat shekullore, ndryshe na merr lumi global! Dritëro Agolli u jep këtë mësim brezave tanë: "Kush harron të kaluarën, nuk ka të ardhmen"! Të mos e harrojë askush!

Më në fund, edhe një këshill për grekët: Njihni historinë që e kanë shkruar stërgjyshërit tuaj, se çfarë gjetën kur erdhën në këto anë, veprat e të cilëve sot i hiqni nga bibliotekat dhe vini mitet tuaja paçavure. Gjua e vjetër greke ka mijëra rrrënjë të gjuhës shqipe, që i huazuat se ishte me e kulturuar dhe dëshmohet sot nga pllakat arkeologjike që nuk lexohen në gjuhën tuaj, por me shqipen lashtësore. Greqishtja e re vijoi huazimin edhe nga gjuha shqipe, që krijuan priftërinjtë tuaj dredharakë të manastireve për të mos u njohur fjalori shqip, që sërish e kini në rrrënjë e greqishtes. Antropologët e kuptojnë fare mirë këtë afri. Për këtë arsye edhe përqindjen e madhe të popullsisë arvanite, Angela Merkel ju porositi: Grekë njihni veten! Shqiptarët do të shtohen me siguri edhe më shumë në të ardhmen atje dhe nuk do të rrinë squk. Mos e merrni si shaka! Për këto arsye, ju serbët nuk bëni më kërkime arkeologjike se aty gjeni pellazgët, ilirët e shqiptarët, që i shani ju palo shovinistë. Vërtini gishtin kukës se shqiptarët janë si krisja, që kure e kor; ajo lëshon rrrënjë më të qarta për t'u përballur me të këqijat e kësaj bote, siç kanë bërë deri sot. Milloshëve na kërcënoi se do na pushtonin me shogatën e gjuetarëve, por vdiq në gjyqin e Hagës, kurse Kotzias na kërcënoi me tërë arsenalin ushtarak grek, por edhe ky ra nga kalaja! Doni më, o palikarë! Kaq kësaj here.

(Ish-kuadër i lartë i Zbulimit Shqiptar, diplomat dhe pedagog)

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Janë ilogari.
- Kufizojnë një trup.
- Janë nocionet e para.
- Janë vendet si Katari.
- Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
- Një pije... dardhe.
- Janë me markë në armaturë.
- Artikull spanjoll.
- Një pjesë e sadistëve.
- Janë shemra.
- Mund të jenë informacioni.
- Fillojnë javën.
- Janë gratë në Marrakesh.
- Janë dhoma.
- Një Ardian guvernator i Bankës.
- Dërmek s'ka kufij.
- Janë centralët si Chernobyl.
- Mbyllin një dyqan.
- Një impiant hi-fi.

- Rolet pa re.
- Një pjesë e parlamentit.
- Kufizojnë një send.
- De Filippi e Amici.
- Pagëzoi Shën Palin.
- Ushtrohet një me trysni.
- Victorien dramaturg.
- Eshtë edhe ai i Zi.
- Fillojnë tatëpjetën.

VERTIKAL

- Hunt aktore.
- Nolde piktor.
- Gjysmw siklet.
- Marsi në Areopag.
- Janë antena satelitore.
- Rrihet në fund.
- Pak tebaizëm.
- Janë taksat.
- Një test.
- Ferrara regjisor.
- Eshtë lutë.
- Kufizojnë citatet.
- Një lëndë e organizmit.
- Qureshin edhe Eumenide.

- Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
- Eshtë si baba.
- Julia i Familja Addmas.
- Jules shkrimtar.
- Role pa zë.
- Mafia pa zë.
- Eshtë zbulurim në skenë.
- Inicialet e Morricone-s.
- Irene aktore.
- Kufij në Oslo.
- George shkrimtare.
- U shkrua nga Emile Zola.
- U shit për një pjatë thjerza.
- Film shqiptar.
- Me të nxjerrin trarë.
- Bega komik.
- Eshtë yll i skuadrës.
- Fillojnë neshjen.
- Satelit i Uranit.
- Inicialet e Dukas kompozitor.
- Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Ndan kapitujt
- Emri i Gonçarov.
- Eshtë e hollë dhe therëse.
- Inicialet e Stone regjisor.
- Eshtë edhe ajo mistral.
- Kryeqyteti i Marokut.
- Ki Moon në OKB.
- Eshtë lloj papagalli.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Gjysmë tandem.
- Hapet me trapano.
- Një sigël maunesh.
- Ishte djali i Odiseut.
- Eshtë sherr në shtyp.
- Artikull spanjoll.
- Eshtë zog i verdhë.
- Mund të jetë kuzhine.
- Inicialet e Lattuada regjisor.
- Eshtë shtet i papës.
- Mbeten në fund.

VERTIKAL


- Një bukanier.
- Mosketieri jezuit.
- Janë zënë në lustë të tillë.
- Pak analogji.
- Gishti pa shi
- Në radhë të parë.
- Tiriac që qe tenist.
- Tregohet nga busullat.
- Kaçaturian kompozitor.
- Fillojnë natën.
- Vallëzon me tutu.
- Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
- Mund të jenë kursimi.
- Janë katër në violinë.
- Janë vendet e pazëna.
- Në mes të Edgar dhe Poe.
- Janë ato që na përkasin.
- Këngëtare italiane.
- Një pjesë e pavijonit.
- Braktisi Didonën.
- Mund të jenë lubrifikantë.
- Lumë në Francë.
- Kush është... do të pijë.
- Nolde piktor.
- Parashtesë zvogëluese.
- Zanore arabe.
- Rastet pa set.
- Pak dramatike.
- Maket pa kufij.
- Inicialet e Nolfe aktor.
- Inicialet e Moravia-s.
- Kështu përfundin një polic.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8		2	9	6				
		7						5
				1			4	
1	9					2		
		8						
	6					7		
	5	9					7	
		6		3	1	5		
				2		8		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	7	3	1	8	5	2	4	6
4	1	2	9	6	7	5	3	8
5	6	8	2	3	4	7	9	1
2	8	9	5	7	3	6	1	4
6	3	5	4	9	1	8	2	7
1	4	7	6	2	8	9	5	3
3	9	6	7	4	2	1	8	5
7	5	4	8	1	9	3	6	2
8	2	1	3	5	6	4	7	9

Argëtim filozofik

- Nuk jemi qenie njerëzore që kanë përvojë shpirtërore. Jemi qenie shpirtërore që kanë përvojë njerëzore.

- Gratë e bukura kurrë nuk dyshojnë në inteligjencën e vet, por gratë inteligjente çdoherë dyshojnë në bukurinë e vet.

- Disa meshkuj kanë atë që e kanë merituar, të tjerët janë të pamartuarit.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

18	5		1	6	9	8	11	8	16	4	8		K	U	L	T	M	A	P	L	A	B		
19	C	16	4	12	7	3		2		1	14		O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R	
8	I	6	3		11		8	8		9	6	1	R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E
3	R	9	5	2	7	3	12	8	9	13		12	B		K	L	E	O	P	A	T	R	A	
9	K	5	2	7	3	1	4	8	15	1	4		I	E	K	I	T	R	E	T	E	S		
9	6	8	12	8	9	7			6		10		L	A	M	E	K	E	R	M	A	T		
4	3	5	9	7		8	3	5	12	8	9	7	T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E	
3		16	1	6	4		7	15	8	4	1		O	T	O	S	C	I	R	M	A			
8	4	1	6	6	1		16	7		7	12	1	B	R	E	D	H	I	A	I	R	K		
13		6	7			11	1	7		4	1	18	I	L	E	I	N	E	P	H	I	L		
11	1	7		17	7	1	12		6	9	17	1	A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	
10	13	4	13	3	8	16	4	7	4		1	3	S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O	

Chënie të mençura

- Të arsimosh një mashkull do të thotë të arsimosh një person; të arsimosh një femër, do të thotë të arsimosh një shoqëri.
- Gjithkush sheh atë që dukesh. Pak kuptojnë atë që jeni.
- Një gënjeshtër në momentin e duhur është 100 herë më e mirë se sa një e vërtetë në momentin e gabuar.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	K	U	T	E	R	I		T	I	M
A	G	A	R	R	E	N	D	M	I	K	E
L	E	M	I	L	E	A	P	E	L	I	M
E	L	E	D	E	P	O	Z	I	T	A	T
A	T	E	K	A	P	A	N	O	N	E	T
L	S	K	A	N	A	R	T	I	N	E	A
E	S	S	E	N	D	A	M	E	A	N	A
C	I	P	A	M	I	T	E	E	M	E	R
M	I	K	A	T	E	T	E	T	I		
K	O	R	R	T	K	U	K	O	L	L	A
U	N	A	Z	A	R	E	N	D	O	R	E
M	I	R	A	N	D	A	B	I	S	H	T
I	R	A	A	R	M	A	D	H	I	T	
T	O	A	P	A	R	A	T	E	T	A	
I	N	R	I	M	O	T	E	T	U	M	
I	R	D	A	M	A	R	E	T	I		
I	A	K	O	T	A	N	T	O	D		
M	K	A	B	I	N	E	T	E	R		
P	U	R	T	E	K	E	E	T	I		
P	E	R	S	E	T	I	N	T			
L	A	O	I	G	O	L	A	L			
I	H	R	T	P	E	T	E	R			
V	O	L	E	L	E	N	D				

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



